



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

*Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship
and Trade*

Monitorimi i Zbatimit të Strategjisë për Zhvillim Industrial dhe Mbështetje të Biznesit dhe Plani i Veprimit 2023-2025

**Për Periudhën
(2024)**

Mars, 2025



PËRMBAJTA

Lista e Shkurtesave.....	2
Lista e Grafikëve.....	3
Lista e Tabelave.....	3
I PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4
Metodologjia.....	5
II PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË STRATEGJISË.....	6
Progresi kundrejt objektivit strategjik 1: Zgjerimin/shtrirjen e prodhimit industrial..	8
Progresi kundrejt objektivit strategjik 2: Reduktimi i deficitit tregtar industrial.....	10
Progresi kundrejt objektivit strategjik 3: Gjenerimi i punësimit më të mirë dhe gjithëpërfshirës.....	13
Progresi kundrejt objektivit strategjik 4 Objektivit strategjik: Lehtësimi i industrisë qarkore dhe të gjelbër.....	15
Progresi kundrejt objektivit strategjik 5 Objektivit strategjik: Maksimizimi i përfitimit të brendshëm.....	17
III TREGUESIT KRYESORË TË NDIKIMIT TË MASAVE PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE.....	20
Objektivit strategjik 1: Zgjerimi i prodhimit industrial.....	20
Objektivit strategjik 2: Reduktimi i deficitit tregtar industrial.....	21
Objektivit strategjik 3: Gjenerimi i punësimit më të mirë dhe gjithëpërfshirës.....	22
Objektivit strategjik 4: Lehtësimi i industrisë qarkore dhe të gjelbër.....	24
Objektivit strategjik 5: Maksimizimi i përfitimit të brendshëm.....	25
IV RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE.....	26
Problemet dhe rreziqet.....	26
Hapat e ardhshëm.....	26
V ANEKS 1. ZBATIMI I AKTIVITETEVE TË SZHIMB – 2030, PLANI I VEPRIMIT 2023 – 2025, PËR PERIUDHËN (KORRIK 2023 – DHJETOR 2024).....	29



Lista e shkurtesave

ASK – Agjencia e Statistikave të Kosovës

BERZH- Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

BPV- Bruto produkti vendor

DAK- Drejtoria e Akreditimit të Kosovës

DI- Departamenti i Industrisë

GIZ- Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar

KIESA- Agjencia Kosovare për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve

MINT-Ministria e Industrisë, Ndërmarrsisë dhe Tregtisë

MFPT- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

MTL- Marrëveshje e Tregtisë së Lirë

OZHQ - Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

PSWD- Zhvillimi i Fuqisë Punëtore të Udhëhequr nga Sektori Privat / Projekt i IREX/USAID

QK- Qeveria e Kosovës

SZHI&MB - Strategjia për Zhvillim Industrial dhe Mbështetje të Biznesit

SKZH- Strategjia Kombëtare për Zhvillim

UNDP- Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

USAID- Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

VShP- Vlera e Shtuar e Prodhimit

ZKM- Zyra e Kryeministrit



Lista e grafikëve

Grafiku 1.	Përqindja e aktiviteteve të realizuara, pjesërisht të realizuara dhe të parealizuara.....	6
Grafiku 2.	Aktivitetet e realizuara, pjesërisht të realizuara dhe të pa realizuara gjatë periudhës (2023-2024), sipas objektivave strategjike.....	7
Grafiku 3.	Përqindja e aktiviteteve të realizuara, pjesërisht të realizuara dhe të pa realizuara gjatë periudhës (2023-2024), sipas objektivave specifike të Objektivit strategjik 1.....	8
Grafiku 4.	Aktivitetet e realizuara, pjesërisht të realizuara dhe të pa realizuara gjatë periudhës (2023-2024), sipas objektivave specifike të Objektivit strategjik 2.....	11
Grafiku 5.	Aktivitetet e realizuara, pjesërisht të realizuara dhe të pa realizuara gjatë periudhës (2023-2024), sipas objektivave specifike të Objektivit strategjik 3.....	13
Grafiku 6.	Aktivitetet e realizuara, pjesërisht të realizuara dhe të pa realizuara gjatë periudhës (2023-2024), sipas objektivave specifike të Objektivit strategjik 4.....	16
Grafiku 7.	Aktivitetet e realizuara, pjesërisht të realizuara dhe të pa realizuara gjatë periudhës (2023-2024), sipas objektivave specifike të Objektivit strategjik 5.....	18

Lista e tabelave

Tabela. 1.	Objektivi strategjik: Zgjerimi i prodhimit industrial dhe treguesit e veprimit.....	20
Tabela. 2.	Objektivi strategjik: Reduktimi i deficitit tregtar dhe treguesit e veprimit.....	21
Tabela. 3.	Objektivi strategjik: Gjenerimi i punësimit më të mire dhe gjithëpërfshirës dhe treguesit e veprimit.....	22
Tabela. 4.	Objektivi strategjik: Lehtësimi i industrisë qarkore dhe të gjelbër dhe treguesit e veprimit.....	24
Tabela. 5.	Objektivi strategjik: Maksimizimi i profitit të brendshëm dhe treguesit e veprimit.....	25

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Strategjia për Zhvillim Industrial dhe Mbështetje të Biznesit (SZHIMB) 2030 dhe Plani i Veprimit (2023-2025), u miratua në Qershor të vitit 2023. Strategjia është përgatitur nga Qeveria e Kosovës (QK) për të ofruar një kornizë strategjike të politikave për nxitjen e zhvillimit industrial. Hartimi i këtij dokumenti strategjik shpreh rëndësinë që QK i kushton sektorit të prodhimit në arritjen e një transformimi strukturor të ekonomisë së Kosovës.

Vizioni i Politikës Industriale të Kosovës është që, “Deri në vitin 2030, industria e Kosovës do të jetë transformuar në një industri më të integruar globalisht e cila është në gjendje të prodhojë produkte me vlerë të lartë të shtuar dhe të ofrojë punësim të denjë”.

Politika Industriale është hartuar duke përdorur një metodologji të njohur “*Ngritja e Cilësisë së Politikave Industriale*”, e cila është krijuar për të mbështetur vendet në zhvillimin e politikave industriale gjithëpërfshirëse të bazuara në diagnostikime të fuqishme. Logjika e ndërhyrjes së Politikës Industriale është zhvilluar, së pari, duke përcaktuar objektivat strategjike përkatëse të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit (SKZH 2030), të cilat do të ndikoheshin pozitivisht nga një bazë industriale në rritje. Së dyti, bazuar në këto përafrime me SKZH-në, u formuluan objektivat konkrete të Politikës Industriale. Së treti, duke kuptuar mungesat themelore në strukturën e kapaciteteve industriale në Kosovë, mund të identifikohen ndryshime specifike (në tekstin e mëtejme "nën-objektiva"), që kërkohen për të arritur objektivat e politikës industriale. Së katërti, nën-objektivat e identifikuar siguruan bazën për të zhvilluar veprimet kryesore të politikës industriale dhe planin e përgjithshëm të veprimit.

Objektivat dhe nën-objektivat e Politikës Industriale janë identifikuar, bazuar në një analizë gjithëpërfshirëse të performancës ekonomike, sociale dhe mjedisore të sektorit të prodhimit.

Për të lehtësuar shpalosjen e potencialit zhvillimor të sektorit të prodhimit në Kosovë dhe për të kontribuar në arritjen e qëllimeve strategjike të SKZH 2030, strategjia ka pesë objektiva politikash: 1) zgjerimin/shtrirjen e prodhimit industrial; 2) zvogëlimin e deficitit tregtar industrial; 3) krijimin e punësimit të denjë dhe gjithëpërfshirës; 4) mbështetjen e rritjes së një industrie të gjelbër dhe qarkore dhe 5) maksimizimin e rritjes së përfitimit të brendshëm . Arritja e këtyre objektivave të politikës varet nga ndryshimet e rëndësishme që duhen bërë në 16 objektiva specifike dhe 75 aktivitete.

Raporti i monitorimit për vitin 2024, ka për synim të ofroj në mënyrë të përmbledhur zbatimin e objektivave strategjike, objektivave specifike dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit të SZHIMB 2030.

Strategjia për Zhvillim Industrial dhe Mbështetje të Biznesit 2030, është horizontale e ndërlidhur me institucionet tjera dhe donatorët. Gjatë procesit të monitorimit ka pasur vonesa dhe mos ofrim të dhënave të plota për zbatim të aktiviteteve nga institucionet përgjegjëse për zbatim të aktiviteteve të SZHIMB.



Metodologjia

Zbatimi i aktiviteteve të Strategjisë për këtë raport, bazohet ekskluzivisht mbi raportimet e institucioneve përgjegjëse dhe përkrahëse për zbatimin e aktiviteteve. Njësitë, departamentet, apo institucionet të cilat janë përfshirë në raportim, janë sipas vendimit të datës 13 nëntor 2023, sipas të cilit edhe është themeluar Organi koordinues ndër-ministror për të siguruar monitorimin dhe vlerësimin e rregullt, kryerjen e rishikimeve të përkohshme dhe vlerësimin përfundimtar të Strategjisë.


Format e raportimit janë përpiluar, duke dërguar kërkesat për raportim te institucionet përgjegjëse dhe përkrahëse te akterët gjegjës të Strategjisë që është dashur të raportojnë. Mënyra e raportimit nga akterët është bazuar në dërgimin e inputeve përmes postës elektronike. Departamenti i Industrisë ka dërguar format e raportimit (sipas strukturës së përshkruar më lart) përmes e-mailit tek të gjithë anëtarët e organit koordinues ndër-ministror për zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë. Anëtarëve iu është dhënë afat prej rreth dy javësh dhe kërkesa të përsëritura, që t'i raportojnë inputet e tyre duke dërguar tek Departamenti i Industrisë format e plotësuar. Pas dërgimit të formave të plotësuar, Departamenti i Industrisë ka konsoliduar inputet dhe është zhvilluar analiza. Analiza e inputeve në raste të caktuara është shoqëruar me takime tematike me zyrtar përgjegjës, por edhe me korrespondencë shtesë përmes postës elektronike për marrjen e informatave plotësues për zbatimin e aktiviteteve. Cilësia e raportimit duhet të përmirësohet në raportimet tjera. Përgjithësisht, raportimi nga akterët është kufizuar në raportimin e zbatimit të aktiviteteve gjatë vitit 2023 dhe 2024, duke mos ofruar produktin.

Mungesa e të dhënave për arritjen e treguesve është mjaft komplekse pasi që duhet marrë nga disa burime, të cilat për vitin 2024 ende nuk janë kryer ku dhe vështirëson matjen e ndikimit.

II. PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË STRATEGJISË

Zbatimi i objektivave të përcaktuara në planin e veprimit të Strategjisë, është përshkruar në këtë pjesë. Në planin e veprimit 2023-2025 të strategjisë, deri në dhjetor 2024 janë paraparë të realizohen dhe të fillojnë për zbatim 69 aktivitete. Nga gjithsej 71 aktivitete, 27 aktivitete janë realizuar plotësisht, 24 janë realizuar pjesërisht/në proces dhe 20 aktivitete nuk janë realizuar.

Grafiku 1. Përqindja e aktiviteteve të realizuara, pjesërisht të realizuara dhe të pa realizuara




Burimi: të dhënat nga raportimi i institucioneve përgjegjëse dhe përkrahëse për zbatim të planit të veprimit të SZHIMB-2024

Në raportin gjashtëmuor të vitit 2023, është konstatuar se ngecjet në zbatimin e disa aktiviteteve të parapara në planin e veprimit, tregojnë për domosdoshmërinë e marrjes së hapave konkretë për eliminimin e barrierave që pengojnë zbatimin e aktiviteteve në afatet kohore të planifikuara dhe se roli i institucioneve përgjegjëse për zbatimin e planit të veprimit është jetik për zhvillimin dhe zbatimin e aktiviteteve të cilat janë planifikuar të realizohen. Mos realizimi i aktiviteteve ka ardhur edhe si rezultat i mos inkorporimit në planet e punës të aktiviteteve për realizim nga institucionet përgjegjëse.

Për zbatimin e planit të veprimit është e domosdoshme ngritja e bashkëpunimit institucional, ndarja e buxhetit si dhe planifikimi i aktiviteteve në planet e punës nga institucionet përgjegjëse.

Vlerësimi i zbatimit të aktiviteteve sipas këtij raporti është ndarë në tri kategori: 1) të realizuara; 2) të realizuara pjesërisht/në proces; dhe 3) të parealizuara.

Grafiku 2. Aktivitetet e realizuara, pjesërisht të realizuara dhe të pa realizuara gjatë vitit 2024, sipas objektivave strategjike.



Burimi: të dhënat nga raportimi i institucioneve përgjegjëse dhe përkrahëse për zbatim të planit të veprimit të SZHIMB-2024

Objektivi strategjik 3, paraqet gjendjen më të mirë në realizim të aktiviteteve, për derisa objektivi 5, është objektivi ku nga 10 aktivitete të planifikuara për zbatim 6 aktivitete nuk janë realizuar.


II.1 Progresi kundrejt objektivit strategjik 1: Zgjerimin/shtrirjen e prodhimit industrial

Objektivi strategjik 1, synon zgjerimin e prodhimit industrial dhe do të ndikoj drejtpërdrejt edhe në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ).

Progresi në arritjen e këtij objektiv do të matet me dy tregues: vlerën e shtuar të prodhimit për kokë banori dhe peshën e vlerës së shtuar të prodhimit ndaj BPV, e cila mat rëndësinë relative të prodhimit në raport me ekonominë e përgjithshme.

Ky objektivi strategjik ka 4 objektiva specifike dhe 26 aktivitete. Për vitin 2024, është planifikuar të realizohen aktivitete në 4 objektiva specifike me 24 aktivitete. Nga 24 aktivitetet, janë realizuar 8 aktivitete apo 33%, pjesërisht të realizuara apo në realizim 10 aktivitete apo 42% dhe të porealizuara 6 aktivitete apo 25%.

Grafiku 3. Përqindja e aktiviteteve të realizuara, pjesërisht të realizuara dhe të pa realizuara gjatë vitit 2024, sipas objektivave specifike të Objektivit strategjik 1.




Burimi: të dhënat nga raportimi i institucioneve përgjegjëse dhe përkrahëse për zbatim të planit të veprimit të SZHIMB-2024

Objektivi specifik 1.1, Lehtësimi i qasjes në financa për prodhuesit vendor: ky objektivi specifik, synon të rrisë fluksin hyrës të kapitalit prodhues veçanërisht në formën e investimeve të huaja, por edhe zgjerimin e investimeve të brendshme private.

Në këtë objektivi specifik, nga tre aktivitetet sa janë planifikuar të realizohen, në proces të realizimit është vetëm një aktivitet.

Aktiviteti 1.1.1. “Hartimi i studimit të fizibilitetit për krijimin e Bankës Zhvillimore të Kosovës” dhe aktiviteti 1.1.2. “Plotësimi i kuadrit rregullator për tregun e letrave me vlerë të korporatave dhe instrumenteve tjera të ngjashme të financimit”, nuk janë realizuar edhe pse janë planifikuar për zbatim në vitin 2024.



Aktiviteti 1.1.3. “Krijimi i Zyrës Këshilluese për Qasje në Financa”, është në proces të inicimit të hartimit të akteve nënligjore nga Ligji i Investimeve të Qëndrueshme. Draft rregullorja për strukturimin e KIESA-s është në shqyrtim.

Objektivi specifik 1.2, rritja e investimeve në prodhim: ky objektivi specifik, përmes rritjes së kredive nga bankat komerciale, por edhe obligacionet e korporatave dhe instrumentet e tjera alternative, synon të rris financimin e kapitalit shtesë, ku i lejon prodhuesit të zgjerojnë kapacitetet e tyre prodhuese për të konkurruar si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

Në këtë objektivi specifik janë realizuar 4 aktivitete apo 50%, 3 aktivitetet janë realizuar pjesërisht dhe 1 aktivitet nuk është realizuar.

Aktiviteti 1.2.8. “Ofrimi i lehtësirave në tatim në të ardhurat e korporatave për investime strategjike”, ky aktivitet nuk është realizuar edhe pse është planifikuar për zbatim në vitin 2023. Nga MFPT është kërkuar të largohet nga plani i veprimit pasi që nuk do të realizohet.

Treguesit: Arritja e objektivit specifik 1.2, do të matet me dy tregues: (i) përqindja e IHD-ve të prodhimit në totalin e IHD-ve (%); dhe (ii) përqindja/pjesa e mallrave kapitale të importuara në VShP.

Objektivi specifik 1.3 përshpejtimi i digjitalizimit në prodhim: ka për synim, ngritjen e dixhitalizimit të sektori të prodhimit, që nënkupton aplikimin e mjeteve dixhitale për rritjen e efikasitetit dhe produktivitetit në menaxhim dhe prodhim, si dhe lëvizjen drejt automatizimit të drejtuar nga të dhënat.

Në këtë objektivi specifik, në periudhën 2023-2024, janë planifikuar të realizohen 4 aktivitete, nga të cilat 1 aktivitet është realizuar, 1 është në proces të realizimit dhe 2 aktivitete nuk janë realizuar.

Aktiviteti 1.3.5 “Krijimi i modeleve të marrëveshjeve për mbrojtjen e të dhënave bazuar në legjislacionin në fuqi për t’ju shërbyer kompanive prodhuese dhe bizneseve tjera”, ky aktivitet është në proces të realizimit, do të realizohet në kuadër të “Fokus Grupeve të Industrisë Prodhuuese” që organizohen nga DI në 7 regjionet e Kosovës dhe do të ju ofrohen bizneseve informata për ligjet në fjalë.

Aktiviteti 1.3.1 “Organizimi i ekspozitës digjitale për industrinë e prodhimit”, planifikohet të realizohet në vitin 2025, ndërsa aktiviteti 1.3.3 “Ofrimi i objekteve publike për hapje të qendrave të inovacionit digjital në shërbim të industrisë”, nuk është realizuar.

Treguesit: Arritja e objektivit specifik 1.3, do të matet me treguesin e mëposhtëm: (i) përdorimi i mjeteve të dixhitalizimit në proceset e përgjithshme të prodhimit/punës në prodhim (%).

Objektivi specifik 1.4 Rritja e cilësisë dhe certifikimit të produkteve të njohura ndërkombëtarisht: ka për synim, cilësinë e produktit, përfshirë specifika të ndryshme si siguria, qëndrueshmëria ose pajtueshmëria me normat e përcaktuara të produktit dhe që mund të vërtetohet me një certifikatë përkatëse.

Objektivi specifik 1.4 për realizim në periudhën 2023 –2024, ka gjithsej 9 aktivitete, nga të cilat 3 aktivitete janë realizuar, 5 janë në proces të realizimit dhe 1 aktivitet nuk është realizuar.

Dy aktivitete të cilat janë në proces të vlerësimit dhe të cilat janë me rrezik të lartë për mos realizim deri në përfundim të vitit 2025 janë, aktiviteti 1.4.2 “Ofrimi i mbështetjes financiare për trupat për vlerësim të konformitetit (TVK) për të përmirësuar pajisjet e tyre dhe për të ndërtuar kapacitete operationale “ dhe 1.4.3 “Hartimi i planit të veprimi që parashtron hapat që do të ndërmerren nga Drejtoria e Akreditimit të Kosovës (DAK) për të përmbushur kërkesat për anëtarësim të plotë në organizatën Evropiane për Akreditim (EA)”.

Aktiviteti 1.4.5 “Hartimi i akteve nënligjore që derivojnë nga ligji për mbikëqyrjen e përputhshmërisë së produkteve në treg”, do të realizohet pas miratimit të ligjit.

Treguesit: Arritja e objektivit specifik 1.4, do të matet me treguesin e mëposhtëm: (i) numrin e produkteve industriale të eksportuara në BE (të paktën €10 mijë në vit).

II.2 Progresi kundrejt objektivit strategjik 2: Reduktimi i deficitit tregtar industrial


Objektivi strategjik 2, fokusohet në uljen e deficitit tregtar industrial. Kjo përfshin si eksportimin e më shumë mallrave të prodhuara nga Kosova në tregjet e huaja, por edhe zëvendësimin e importeve të mallrave të përpunuara në Kosovë me prodhim vendor.

Progresi në arritjen e këtij objektivit të politikës do të matet nga bilanci tregtar i prodhimit, i llogaritur si eksportet e prodhuara, minus importet e prodhuara.

Ky objektivi strategjik, ka 3 objektiva specifike dhe 18 aktivitete. Për vitin 2023 dhe 2024, është planifikuar të realizohen aktivitete në 3 objektiva specifike me 18 aktivitete.

Nga 18 aktivitete janë realizuar 8 aktivitete apo 45%, pjesërisht të realizuara apo në realizim 4 aktivitete apo 22% dhe të përealizuara 6 aktivitete apo 33%.

Grafiku 4. Aktivitetet e realizuara, pjesërisht të realizuara dhe të pa realizuara gjatë vitit 2024, sipas objektivave specifike të Objektivit strategjik 2.



Burimi: të dhënat nga raportimi i institucioneve përgjegjëse dhe përkrahëse për zbatim të planit të veprimit të SZHIMB-2024

Objektivi specifik 2.1 Mbështetja e ndërmarrjeve për të shfrytëzuar potencialin e tyre të eksportit: synon që kompanive në Kosovë të cilat kanë produkte ose posedojnë aftësi për të prodhuar produkte dhe janë konkurruese në tregjet ndërkombëtare, duhet t'u mundësohet dalja në tregun jashtëm.

Në kuadër të këtij objektivi specifik janë planifikuar të realizohen 9 aktivitete duke përfshirë vitet 2023-2025 mirëpo prej tyre janë realizuar 5 aktivitete me 55.6%, ndërsa 2 aktivitete me 22% janë realizuar pjesërisht, si dhe dy të tjera me 22% nuk janë realizuar.

Aktiviteti 2.1.2 “Krijimi i Qendrës së Informacioneve për Tregun e Eksportit (EMIC)”, është realizuar pjesërisht pasi që është në proces të inicimit të hartimit të akteve nënligjore nga Ligji i Investimeve të Qëndrueshme. Draft rregullorja për strukturimin e KIESA-s është në shqyrtim.

Aktiviteti 2.1.6 “Kryerja e një analize për të vlerësuar ndikimin e aktiviteteve për promovim të eksporteve”, janë realizuar anketa me kompanitë e Kosovës të sektorëve të ndryshëm pjesëmarrëse në aktivitetet ndërkombëtare.

Aktiviteti 2.1.7 “Krijimi i programi për mentorim për të lidhur anëtarët e diasporës së Kosovës me përvojë në prodhim me eksportuesit potencial” dhe Aktiviteti 2.1.9 “Angazhimi i anëtarëve të diasporës për të ndihmuar eksportet në industri në kuadër të Programit për Diplomaci Qytetare”, nuk janë realizuar pasi që nuk kanë raportuar për këto aktivitete.

Treguesit: Arritja e objektivit specifik 2.1 do të matet me treguesin e mëposhtëm: (i) numri i ndërmarrjeve prodhuese që eksportojnë rregullisht (të paktën 10 mijë euro në vit).

Objektivi specifik 2.2, Diversifikimi i tregjeve të eksportit: fokusohet në zgjerimin e eksporteve në përgjithësi, duke përfshirë diversifikimin e produkteve të eksportit, ky nën-objektiv, fokusohet në diversifikimin e tregjeve të eksportit.

Në kuadër të këtij objektivi specifik janë planifikuar të realizohen 3 aktivitete duke përfshirë vitet 2023-2024, prej tyre janë realizuar 2 aktivitete apo 66.7%, ndërsa 1 aktivitet apo 33.3% nuk është realizuar.

Aktiviteti 2.2.1 “Përgatitja e analizës për identifikimin e listës së produkteve prodhuese strategjike për eksport”, është realizuar gjatë vitit 2023.

Aktiviteti 2.2.2 “Negocimin e tri marrëveshjeve tregtare me fushëveprim të pjesshëm”, është nënshkruar marrëveshja me vendet e EFTA-s, po ashtu është negociuar zbatimi i marrëveshjes tregtare me Mbretërinë e Bashkuar.

Aktiviteti 2.2.3 “Mbështetje për krijim të brendeve të jashtme për lehtësimin e depërtimit të ndërmarrjeve prodhuese në tregjet e reja të eksportit, në bashkëpunim me partnerët e jashtëm biznesor dhe të diasporës” mirëpo nuk është raportuar për zbatimin e këtij aktiviteti.

Treguesit: Arritja e objektivit specifik 2.2, do të matet me treguesin e mëposhtëm: (i) diversiteti gjeografik i eksporteve (numri i vendeve që zënë 80% të eksporteve të prodhimit).

Objektivi specifik 2.3 Zëvendësimi i importit të produkteve të ndërmjetme dhe përfundimtare me prodhime vendor dhe promovimin e produkteve vendore: synon uljen e importit të mallrave të prodhuara. Mallrat e ndërmjetme dhe përfundimtare të importuara, të cilat prodhuesit kosovarë janë në gjendje të prodhojnë, duhet të zëvendësohen gradualisht nga prodhimi vendor.

Në kuadër të këtij objektivi specifik janë planifikuar të realizohen 6 aktivitete duke përfshirë vitet 2023-2025, mirëpo prej tyre është realizuar 1 aktivitet apo 16.7%, ndërsa 2 aktivitete apo 33.3% janë realizuar pjesërisht, si dhe 3 aktivitete apo 50% nuk janë realizuar .

Aktiviteti 2.3.1 “Përgatitja e analizës për të identifikuar produktet finale të importuara me potencial për t’u zëvendësuar” aktivitet i cili është realizuar. Analiza e përfunduar - Fondet e LUX/DEV.

Aktiviteti 2.3.2 “Përmirësimi i regjimit tarifor të importit për të ofruar mbrojtje për produkte strategjike” ky aktivitet pritet të realizohet.

Aktiviteti 2.3.3 “Përfshirja e një marzhe preferenciale kalimtare në prokurim publik për produktet vendore” (shënim: nuk vlen për produktet me origjinë nga BE-ja, CEFTA, SHBA-të dhe EFTA) Është në plan legjislativ për vitin 2025 dhe drafti i përfunduar gjendet në Kabinet.

Aktiviteti 2.3.4.”Ofrimi i granteve për të rinj, përmes qendrave të inovacionit, që të zhvillojnë projekte promovuese kreative për konsumin e produkteve vendore” si dhe aktiviteti 2.3.5 “Lansimi i fushatës informuese për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve për të blerë produkte vendore”. Nuk është raportuar për zbatimin e tyre.

Aktiviteti 2.3.6 Hartimi i politikës tregtare (programit për tregti) Grupi Punues në bashkëpunim me Departamentin e Tregtisë është duke punuar në hartimin e dokumentit/programit për Politika Tregtare. Fondet e UNDP-së

Treguesit: Arritja e objektivit specifik 2.3 do të matet me tre tregues: (i) pjesa e importeve të mallrave të ndërmjetme të zëvendësueshme (sipas klasifikimit BEC) në totalin e importeve; (ii) pjesa e importeve të mallrave të konsumit të zëvendësueshme (sipas klasifikimit BEC) në totalin e importeve dhe (iii) përqindja e mallrave vendore në tregun e prodhimit.


II.3 Progresi kundrejt objektivit strategjik 3: Gjenerimi i punësimit më të mirë dhe gjithëpërfshirës

Objektivi strategjik 3, fokusohet në gjenerimin e punësimit më të mirë dhe gjithëpërfshirës në prodhim. Kjo do të thotë të mbështetet dhe të përshejtohet potencialisht rritja pozitive e punësimit në industri, por në të njëjtën kohë, të rritet cilësia e vendeve të punës.

Progresi në arritjen e këtij objektiv do të matet nga dy tregues: a) punësimi në prodhim për kokë banori, i cili do të përcaktojë se është fuqia punëtore, si përqindje e popullsisë, e angazhuar në prodhim; dhe b) faturën e pagave të prodhimit si pjesë e VShP-së, e cila do të masë të ardhurat totale të punës në prodhim si pjesë e vlerës së shtuar të prodhimit.

Ky objektivi strategjik, ka 3 objektiva specifike dhe 12 aktivitete. Për vitin 2023-2024, janë realizuar 7 aktivitete ndërsa 5 aktivitete janë në proces të realizimit.

Grafiku 5. Aktivitetet e realizuara, pjesërisht të realizuara dhe të pa realizuara gjatë vitit 2024, sipas objektivave specifike të Objektivit strategjik 3.



Burimi: të dhënat nga raportimi i institucioneve përgjegjëse dhe përkrahëse për zbatim të planit të veprimit të SZHIMB-2024

Objektivi specifik 3.1 Kualifikimi dhe certifikimi i fuqisë punëtore teknike dhe menaxherëve të ndërmarrjeve: ky objektivi specifik synon ofrimin e një fuqie punëtore të kualifikuar si faktor kyç i prodhimit, me qëllim për të prodhuar mallra që mund të konkurrojnë në bazë të çmimit, cilësisë dhe inovacionit. Në të njëjtën kohë, rritja e bizneseve varet edhe nga menaxherët profesionistë, të cilët mund t'i udhëheqin kompanitë nëpër faza të ndryshme të ciklit të tyre të rritjes.

Ky objektivi specifik ka gjithsej 7 aktivitete, 5 aktivitetet e planifikuara janë në proces të zbatimit, apo 71.4% dhe 2 aktivitete apo 28.6% janë realizuar plotësisht.

Aktiviteti 3.1.3. “Hartimi i ligjit për këshillat industriale”, është realizuar pjesërisht dhe institucion përgjegjës është MFPT, MINT dhe USAID, por ky aktivitet ka kaluar të trajtohet në kuadër të Ligjit për Odën Ekonomike të Kosovës, ku do të përfshihen edhe këshillat industriale.

Aktiviteti 3.1.4. “Krijimi i programit të punësimit në prodhim në kuadrin e Masave Aktive të Tregut të Punës”, është realizuar pjesërisht dhe institucion përgjegjës për zbatim është MFPT konkretisht Agjencia e Punësimit. Ky aktivitet është duke u realizuar përmes projektit super puna por mungojnë të dhënat për numrin e përfutueseve në sektorin prodhues.

Aktiviteti 3.1.5. “Krijimi i kredit-skemës për ngritje të shkathtësive në treg të punës”, është realizuar pjesërisht dhe institucion përgjegjës është MFPT (Agjencia e Punësimit) dhe ASHI. MINT në kuadër të projektit KSV-023 dhe KSV-021 nga Lux/Dev është duke e hartuar skemën për ri trajnimin e punëtorëve dhe përfshirjen e mësimin dual.

Aktiviteti 3.1.6. “Mbështetje për hapjen e qendrave trajnuese të akredituara jo publike me programe për ngritje e shkathtësive në industri”, është në proces dhe institucion përgjegjës janë MFPT dhe WBF, në këtë aktivitet janë parashikuar të hapen 6 qendra të reja trajnuese, në mbështetje të projektit KSV-021 nga Lux/Dev, për disa sektor si: Agro – përpunuese, druri, TIK, dhe energji të ripërtërihem.

Aktiviteti 3.1.7. “Mbështetje për hartimin e programeve trajnuese për zhvillim të shkathtësive në industri”, është realizuar pjesërisht dhe përgjegjës për implementim është MASHT-i dhe USAID (PSWD). Janë parashikuar 15 programe trajnuese të reja të krijuara nga Programi i PSWD, në USAID/IREX, ka krijuar grupet punuese për vitin 2024/2025, por janë ndërprerë për shkak të pezullimit (ndalimit), të fondeve nga USAID në Kosovë.

Treguesit: Arritja e objektivit specifik 3.1 do të matet me katër tregues: (i) numrin e institucioneve të akredituara të trajnimit në prodhim; (ii) numrin e standardeve të miratuara të profesionit në prodhim; (iii) përqindjen e punëtorëve që marrin trajnim formal në prodhim (%); dhe (iv) numrin e certifikatave ISO.

Objektivi specifik 3.2 Promovimi i krijimit të vendeve të denja të punës në industri: ka për synim krijimin e vendeve të punës në prodhim, krijimin e vendeve të denja të punës, për të siguruar që prodhuesit të paguajnë të ardhura të drejta, të sigurojnë punësim të sigurt dhe të përmirësojnë kushtet e përgjithshme të punës.

Ky objektivi ka gjithsej 2 aktivitete të planifikuara të cilat janë realizuar në vitin 2023.

Treguesit: Arritja e objektivit specifik 3.2 do të matet me tre indikatorë: (i) punëtorët e prodhimit të deklaruar në ATK/punësimin zyrtar në prodhimtari; (ii) varfërinë në punë në procesin e prodhimit; dhe (iii) numrin e aksidenteve në punë në procesin e prodhimit.

Objektivi specifik 3.3 Integrimi i grave dhe të rinjve në tregun e punës dhe në biznes: synon punësim gjithëpërfshirës në prodhim/përpunim, në mënyrë që të arrihet punësim më i gjerë dhe gjithëpërfshirës, i cili krijon përfitime për të gjithë shoqërinë. Gratë dhe të rinjtë, si dhe grupe të tjera të pa-favorizuara, në veçanti, duhet të integrohen më mirë në tregun e punës në sektorin e prodhimit në Kosovë.

Ky objektivi ka gjithsej 3 aktivitete të planifikuara të cilat janë realizuar në vitin 2023-2024. Aktiviteti 3.3.1 “Organizimi i javës së grave në industri”, ky aktivitet është realizuar nga KIESA.

Treguesit: Arritja e objektivit specifik 3.3 do të matet me dy tregues: (i) përqindjen e të rinjve të punësuar në prodhim në punësimin total të të rinjve; dhe (ii) përqindjen e grave të punësuar në prodhim.


II.4 Progresi kundrejt objektivit strategjik 4 Objektivi strategjik: Lehtësimi i industrisë qarkore dhe të gjelbër

Objektivi strategjik 4, Objektivi i katërt i politikës industriale, është të inkurajojë sektorin e prodhimit të kalojë në prodhim të gjelbër. Krijimi i një industrie të gjelbër synon të shkëputë rritjen ekonomike nga eksternalitetet negative mjedisore duke maksimizuar zbatimin e strategjive qarkore, aplikimin e energjisë nga burimet e rinovueshme dhe përdorimin efikas të inputeve.

Progresi në arritjen e këtij objektivit të politikës do të matet me dy tregues: a) Emetimet e CO2 për njësi VShP, që mat reduktimet në intensitetin e CO2 të aktivitetit prodhues; dhe b) një tregues riciklimi/qarkullimi.

Ky objektivi strategjik, ka 3 objektiva specifike dhe 8 aktivitete. Për vitin 2023-2024, janë planifikuar të realizohen 5 aktivitete, ndërsa 3 aktivitete janë paraparë të realizohen në vitin 2025 edhe pse për 2 nga këto aktivitete nuk është raportuar.

Grafiku 6. Aktivitetet e realizuara, pjesërisht të realizuara dhe të pa realizuara gjatë vitit 2024, sipas objektivave specifike të Objektivit strategjik 4.



Burimi: të dhënat nga raportimi i institucioneve përgjegjëse dhe përkrahëse për zbatim të planit të veprimit të SZHIMB-2024

Objektivi specifik 4.1 Mbështetje për ndërmarrjet për të rritur riciklimin dhe qarkullimin në prodhim: ka për synim të maksimizojë efikasitetin në përdorimin e burimeve, të zvogëlojë ndikimet negative mjedisore dhe të zvogëlojë kostot, duke siguruar që mbeturinat e rikuperuara të rifuten në prodhim, në këtë objektivi janë realizuar 2 aktivitete, ndërsa 1 aktivitet është realizuar pjesërisht.

Aktiviteti 4.1.1 “Organizimi i seminareve për ndërmarrjet prodhuese për t’i njoftuar ato me bazat e modeleve të biznesit të ekonomisë qarkore” Në muajin tetor janë realizuar dy takime me biznese për t’i njoftuar me programin lidhur me bazat e modeleve të biznesit të ekonomisë qarkore. Kanë marr pjesë gjithsej 50 biznese, si dhe të njëjtat janë trajnuar në modulën e tranzicionit të gjelbër. Aktivitet i realizuar në bashkëpunim me programin (Boost), UNDP.

Aktiviteti 4.1.2 “Promovimi i simbiozave industriale për të lehtësuar shkëmbimin e materialeve (nën-produkteve) ose vijave të mbetjeve” Në kuadër të promovimit të industrisë së gjelbër janë promovuar edhe simbioza në industri. Janë shpërndarë 12 grante për biznese që promovojnë simbiozat industriale, transformimin e gjelbër dhe digjital. Aktivitet i realizuar në bashkëpunim me programin (Boost), UNDP.

Aktiviteti 4.1.3 “Promovimi i simbiozave industriale për të lehtësuar shkëmbimin e materialeve (nën-produkteve) ose vijave të mbetjeve” Krijimi i dritarës për inovacion drejt ekonomisë qarkore në kuadër të fondit të inovacionit.

Treguesit: Arritja e objektivit specifik 4.1 do të matet me dy tregues: (i) vlerën e shtuar bruto në sektorët që lidhen me ekonominë qarkore (% e BPV-së totale); dhe (ii) përdorimin e materialit të ricikluar (%).

Objektivi specifik 4.2 Mbështetja e prodhimit dhe konsumit të produkteve të gjelbra:

Ky objektivi ka 4 aktivitete të cilat janë planifikuar të realizohen gjatë vitit 2025.

Objektivi specifik 4.3 Mbështetja e përmirësimit teknologjik me fokus në rritjen e efikasitetit të energjisë dhe materialeve: synon përmirësimin teknologjik, procesin e rritjes së aftësive teknologjike të ndërmarrjeve për të modernizuar metodat e prodhimit.

Në kuadër të këtij objektivit, gjatë vitit 2024, është planifikuar të realizohet 1(një) aktivitet.

Aktiviteti 4.3.1 “Zhvillimi i programit për investime në teknologji të gjelbër në industrinë prodhuese”, aktiviteti është planifikuar të realizohet nga BERZH dhe institucionet tjera financiare partnere, aktiviteti nuk është realizuar. Produkt i këtij aktivitetit do të ishte, 80 ndërmarrje përfituese.

Nuk është realizuar pasi që nuk është alokuar buxheti. Ky aktivitet është modifikuar dhe janë dhënë grante për blerjen e makinerive - teknologjisë për sektorët industrial.

Treguesit: Arritja e objektivit specifik 4.3, do të matet me treguesin e mëposhtëm: intensitetin e energjisë në prodhim (Toe/€M).


II.5 Progresi kundrejt objektivit strategjik 5 Objektivi strategjik: Maksimizimi i përfitimit të brendshëm

Objektivi strategjik 5, Objektivi i pestë i politikës industriale parasheh që Kosova të përfitojë nga zhvillimi industrial në mënyrë gjithëpërfshirëse duke maksimizuar shtimin e vlerës së brendshme në procesin e prodhimit dhe më gjerë.

Progresi në arritjen e këtij objektivit do të matet nga VShP, si një pjesë e produktit të prodhimit, i cili arrinë masën deri në të cilën shtimi i vlerës lokale do të mbështetet në burimet e brendshme.

Ky objektivi strategjik, ka 3 objektiva specifike dhe 11 aktivitete. Për vitin 2023-2024, janë planifikuar të realizohen 10 aktivitete në 3 objektiva specifike. Prej tyre janë realizuar dy aktivitete, apo 20%, në proces janë dy aktivitete, apo 20% ndërsa nuk janë realizuar 6 aktivitete apo 60%.

Grafiku 7. Aktivitetet e realizuara, pjesërisht të realizuara dhe të pa realizuara gjatë vitit 2024, sipas objektivave specifike të Objektivit strategjik 5.



Burimi: të dhënat nga raportimi i institucioneve përgjegjëse dhe përkrahëse për zbatim të planit të veprimit të SZHIMB - 2024

Objektivi specifik 5.1 Rritja e pjesëmarrjes së inputeve vendore në prodhim: ka për synim zgjerimin e përdorimit të inputeve të brendshme për të siguruar forcimin e shtimit të vlerës së brendshme.

Nga 3 aktivitete sa janë planifikuar të realizohen në planin e veprimit 2024 është realizuar pjesërisht 1 aktivitet ndërsa nuk janë realizuar 2 aktivitete.

Aktiviteti 5.1.1 “Krijimi i tabelave input-output për të kuptuar strukturën e inputeve të përdorura në industri”, ASK nuk ka ndërmarr ndonjë veprim për realizimin e këtij aktiviteti.

Aktiviteti 5.1.2 “Transpozimi i dispozitave relevante të direktivës së BE-së që kanë të bëjnë me praktikën e padrejta tregtare në zinxhirin e furnizimit në industrinë e ushqimit”, është realizuar pjesërisht. Mund të theksojmë se praktikën e padrejta tregtare janë të përcaktuara në nenin 47 të Ligjit për Tregtinë e Brendshme. Për këtë aktivitet do të koordinohemi me Ministrinë e Bujqësisë. Ata gjithashtu në “Strategjinë për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural për periudhën 2022-2028” kanë një objektivi specifik në këtë drejtim (Objektivi 1.3: Përmirësimi i pozitës së fermerëve në zinxhirin e vlerës), dhe janë duke punuar në aktivitete të transpozimit të direktivave të BE-së.

Aktiviteti 5.1.3 “Hartimi i studimit në lidhje me shfrytëzimin e burimeve natyrore për industrinë”, nuk është realizuar dhe planifikohet të realizohet në vitin 2025, përmes projektit KSV/023 të LUX/DEV.

Treguesit: Arritja e objektivit specifik 5.1 do të matet me treguesin e mëposhtëm: (i) vlerën e importit të produkteve të ndërmjetme (klasifikimi BEC) si pjesë e VShP.

Objektivi specifik 5.2 Përmirësimi i inovacionit të produktit drejt prodhimit me vlerë më të lartë të shtuar: synon prodhim të mallrave më të tregtueshme dhe në veçanti kalimin në produkte me vlerë më të lartë të shtuar, për të përmirësuar shtimin e vlerës së brendshme të Kosovës.

Nga gjithsej 4 aktivitete, 2 aktivitete janë realizuar dhe 2 nuk janë realizuar.

Aktiviteti 5.2.1, “Ndarja e çmimit për inovacion në produkte prodhuese”, nuk është realizuar dhe institucion përgjegjës për zbatimin e këtij aktiviteti është MINT/Departamenti i Inovacionit.

Aktiviteti 5.2.2 “Reduktimi i tatimit në të ardhurat e korporatave për kompanitë e mëdha prodhuese që investojnë në entitete të përzgjedhura inovative”, nuk është realizuar dhe institucion përgjegjës për këtë aktivitet është MINT dhe MFPT. MINT ka kontaktuar dhe dërguar informatat në MFPT për inicimin e zbatimit të këtij aktiviteti, mirëpo nga MFPT, është kërkuar që ky aktivitet të largohet, me që nuk pritet të realizohet një aktivitet i tillë.

Aktiviteti 5.2.3 “Finalizimi i Programit për Pronësinë Industriale” është realizuar që do të thotë se Programi për pronësi industriale është miratuar.

Aktiviteti 5.2.4 “Mbështetja për institucione të arsimit të lartë për krijim të programeve ekzekutive të inovacionit në industri”, për këtë aktivitet nuk është raportuar .

Treguesit: Arritja e objektivit specifik 5.2 do të matet me treguesin e mëposhtëm: përqindjen (%) e ndërmarrjeve që kanë prezantuar një produkt/shërbim të ri, për këtë tregues nuk ka të dhëna.

Objektivi specifik 5.3 Forcimi i lidhjeve me ofruesit e shërbimeve vendase të lidhura me industrinë: synon forcimin e lidhjeve ndërmjet prodhuesve dhe ofruesve të shërbimeve vendase, të minimizoj rrydhjen e vlerës në proceset e prodhimit, me ç’rast shërbimet për prodhim të importohen më pak nga jashtë

Në kuadër të këtij objektivi nga 4 aktivitete të parashikuara, 3 aktivitete janë të përcaktuara në vitin 2023-2024, 1 aktivitet është realizuar, 1 aktivitet është në proces dhe 1 aktivitet nuk është realizuar.

Aktiviteti 5.3.4 “Themelimi i Këshillit Kombëtar për Zhvillim të Industrisë”, është realizuar, pra është themeluar Këshilli Kombëtar për Zhvillim të Industrisë me vendim të kryeministrit.

Aktiviteti 5.3.1 “Zhvillimi i platformës digjitale me profile të detajuara të ofruesve të shërbimeve që lidhen me industrinë”, është realizuar pjesërisht. TeR janë zhvilluar dhe do të realizohet gjatë 2025, me fond të përbashkët të KSV/023 LUX/DEV dhe KIESA.

Aktiviteti 5.3.2 “Mbështetja e masës preventive për mirëmbajtjen e makinerive në ndërmarrje prodhuese” nuk është realizuar në mungesë të buxhetit.

Treguesit: Arritja e objektivit specifik 5.3, do të matet me treguesin e mëposhtëm: (i) shërbimet e brendshme të blera nga industrinë, për këtë tregues nuk ka të dhëna.

III. TREGUESIT KRYESORË TË NDIKIMIT TË MASAVE PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE

Mungesa e të dhënave për vitin 2024, ka ndikuar në mos përcaktimin e ndikimit të performances së sektorit të prodhimit, qoftë në rritjen e kapaciteteve prodhuese, rritjen e vlerës së shtuar, rritjen e cilësisë së produkteve si dhe në krijimin e një pune të dinjitetshme etj. Me gjithat të dhënat e fundit janë kryesisht për vitin 2023.

Objektivi strategjik 1: Zgjerimi i prodhimit industrial

Prodhimi industrial në Kosovë është ende shumë i kufizuar. Pjesa e VShP-së në BPV, nga të dhënat e vitit 2020, të analizës së strategjisë ishte (13.6%), ndërsa nga të dhënat e fundit të vitit 2023, vërehet se ka rënie në pjesëmarrjen e VShP në BPV për 0.68%. Ndërsa VShP në prodhim për kokë banori në vitin 2023, krahasuar me vitin 2020 ka rritje për 117.4 Euro, sipas trendit deri në vitin 2026, do të kaloj treguesin e parashikuar.

Tabela 1. Objektivi strategjik 1: Zgjerimi i prodhimit industrial dhe treguesit e veprimit

1 Nr.	Objektivat strategjike dhe specifike, treguesit dhe veprimet	Vlera bazë	Vlera e fundit (aktuale)	Synimi i përkohshëm (2026)	Synimi i vitit të fundit (2030)
1	Objektivi strategjik: Zgjerimi i prodhimit industrial				
1	Vlera e shtuar në prodhim (VShP) për kokë banori (EUR)	541.5 (2020)	658.9 (2023)	702.1	809.2
2	Pjesëmarrja e VShP në BPV	13.6% (2020)	12.92 (2023)	15.30%	16.50%
1.1	Objektivi specifik: Lehtësimi i qasjes në financa për prodhuesit vendor				
1	Kreditë e brendshme për sektorin privat nga bankat (% e BPV-së)	47.8% (2020)	55.25% (2023)	52%	60%
2	Pjesëmarrja e kredive prodhuese në totalin e kredive komerciale	17.3% (2021)	18.5% (2023)	23.40%	28.20%
1.2	Objektivi specifik: Rritja e investimeve në prodhim				
1	Pjesëmarrja e IHD-ve të prodhimit në totalin e IHD-ve (%)	-0.1% (2021)	1.56% (2023)	10.20%	18.40%
2	Pjesëmarrja e mallrave kapitale të importuara në VShP	41.7% (2020)	44.8% (2022)	48.30%	52.70%
1.3	Objektivi specifik: Përsheptimi i digjitalizimit në prodhim				
1	Përdorimi i mjeteve të digjitalizimit në proceset e përgjithshme të prodhimit/punës në industri (%)	19.3% (2019)	Vlera e fundit viti 2019	35%	45%
1.4	Objektivi specifik: Rritja e cilësisë dhe certifikimit të produkteve të njohura ndërkombëtarisht				
1	Numri i produkteve industriale të eksportuara në BE (të paktën 10,000 EUR në vit)	298 (2021)	Vlera e fundit viti 2021	630	895

Objektivi specifik 1.1: Lehtësimi i qasjes në financa për prodhuesit vendor, në indikatorin “Kreditë e brendshme për sektorin privat nga bankat (% e BPV-së)”, kanë tejkaluar pritshmëritë për deri sa në treguesin “Pjesëmarrja e kredive prodhuese në totalin e kredive komerciale”, ka trend negativ.

Objektivi specifik 1.2: Rritja e investimeve në prodhim, në indikatorin “Pjesëmarrja e IHD-ve të prodhimit në totalin e IHD-ve (%)”, ka progres por me trend të ulët rritje dhe larg arritjes së përqindjes së planifikuar.

Për treguesin “Pjesëmarrja e mallrave kapitale të importuara në VShP”, nuk ka të dhëna pas vitit 2022.

Objektivi specifik 1.3: Përsheptimi i digjitalizimit në prodhim, ka treguesin matës “Përdorimi i mjeteve të digjitalizimit në proceset e përgjithshme të prodhimit/punës në industri (%)”, për të cilin të dhënat statistikore ekzistuese janë të vitit 2019.

Objektivi specifik 1.3: Rritja e cilësisë dhe certifikimit të produkteve të njohura ndërkombëtarisht “Numri i produkteve industriale të eksportuara në BE (të paktën 10,000 EUR në vit)”, për të cilin të dhënat statistikore ekzistuese janë të vitit 2021.

Objektivi strategjik 2: Reduktimi i deficitit tregtar industrial

Bilanci i përgjithshëm tregtar industrial i Kosovës është negativ dhe kemi thellim të deficitit tregtar, vlerësuar sipas të dhënave të ASK në tabelën e poshtëshënuar.

Tabela 2. Objektivi strategjik 2: Reduktimi i deficitit tregtar dhe treguesit e veprimit

2 Nr.	Objektivat strategjike dhe specifike, treguesit dhe veprimet	Vlera bazë	Vlera e fundit (aktuale)	Synimi i përkohshëm (2026)	Synimi i vitit të fundit (2030)
2	Objektivi strategjik: Reduktimi i deficitit tregtar industrial				
1	Deficiti tregtar në industrinë prodhuese (Mil. EUR)	- 2,327.6 (NACE) -2,821.7 (sipas kapitujve) (2020)	-5,053.8 (sipas kapitujve 2023)	-2,037.60 (NACE)	-1,744.40
2.1	Objektivi specifik: Mbështetja e ndërmarrjeve për të shfrytëzuar potencialin e tyre të eksportit				
1	Numri i ndërmarrjeve prodhuese që eksportojnë rregullisht (të paktën 10,000 euro në vit)	733 (2021)	n/a	1,239	2,478
2.2	Objektivi specifik: Diversifikimi i tregjeve të eksportit				
1	Diversiteti gjeografik i eksporteve (numri i vendeve partnere që përbëjnë 80% të eksporteve të prodhimit)	10 (2021)	11 (2023)	14	18
2.3	Objektivi specifik: Zëvendësimi i importit të produkteve të ndërmjetme dhe përfundimtare me prodhime vendor dhe promovimin e produkteve vendore				

1	Pjesëmarrja e importeve të mallrave të ndërmjetme të zëvendësueshme (sipas klasifikimit BEC) në totalin e importeve	31.6% (2020)	46% (2023)	27%	22%
2	Pjesëmarrja e importeve të mallrave të konsumit të zëvendësueshme (sipas klasifikimit BEC) në totalin e importeve	23.2% (2020)	32% (2023)	20%	16%
3	Pjesëmarrja e mallrave vendore në tregun prodhues	32.8% (2020)	n/a	40%	50%

Objektivi specifik 2.1: Objektivi specifik: Mbështetja e ndërmarrjeve për të shfrytëzuar potencialin e tyre të eksportit të dhënat statistikore ekzistuese janë të vitit 2021.

Objektivi specifik 2.2: Diversifikimi i tregjeve të eksportit, sipas të dhënave të vitit 2023 ka progres dhe mund të arrihet synimi i parashikuar për vitin 2026.

Objektivi specifik 2.3: Zëvendësimi i importit të produkteve të ndërmjetme dhe përfundimtare me prodhime vendor dhe promovimin e produkteve vendore, ka tre tregues, dy prej të cilëve “Pjesëmarrja e importeve të mallrave të ndërmjetme të zëvendësueshme (sipas klasifikimit BEC) në totalin e importeve” dhe “Pjesëmarrja e importeve të mallrave të konsumit të zëvendësueshme (sipas klasifikimit BEC) në totalin e importeve” kanë tejkaluar synimin e parashikuar për vitin 2026, ndërsa për treguesin “Pjesëmarrja e mallrave vendore në tregun prodhues” mungojnë të dhënat statistikore

Objektivi strategjik 3: Gjenerimi i punësimit më të mirë dhe gjithëpërfshirës

Nga analiza me të dhënat e disponueshme (viti 2020), gjatë hartimit të strategjisë dhe të dhënave të fundit (viti 2023), vërehet se “Punësimi në prodhim për kokë banori” ka rritje të lehtë prej 2.36% (2023), ku tregohet trendi i ngadalshëm për të arritur synimin në vitin 2026, prej 3.69%.

Treguesi 2, “Totali i pagave të prodhimit në VShP-së, në (%)”, tregon trend negativ të rritjes dhe vlerë e ulët për të arritur synimin në vitin 2026.

Tabela 3. Objektivi strategjik 3: Gjenerimi i punësimit më të mirë dhe gjithëpërfshirës dhe treguesit e veprimt

3 Nr.	Objektivat strategjike dhe specifike, treguesit dhe veprimet	Vlera bazë	Vlera e fundit (aktuale)	Synimi i përkohshëm ë2026]	Synimi i vitit të fundit ë2030]
3	Objektivi strategjik: Gjenerimi i punësimit më të mirë dhe gjithëpërfshirës				
1	Punësimi në prodhim për kokë banori	2,34 (2020)	2,36 (2023)	3,69	4,59
2	Totali i pagave të prodhimit në VShP (%)	34.5% (2020)	21% (2023)	51.50%	62.90%

3.1 Objektivi specifik: Kualifikimi dhe certifikimi i fuqisë punëtore teknike dhe menaxherëve të ndërmarrjeve					
1	Numri i institucioneve të akredituara të trajnimit për industri të prodhimit	11 (2021)	12(2023/24)	20	35
2	Numri i standardeve të profesionit të miratuara në industrinë e prodhimit	24 (2021)	17(2023/24)	40	60
3	Përqindja e punëtorëve që marrin trajnim formal në prodhim (%)	26.4% (2019)	n/a	35%	42%
4	Numri i certifikatave ISO të lëshuara në Kosovë	n/a	n/a	Mesatarja e BP	Mesatarja e BP
3.2 Objektivi specifik: Promovimi i krijimit të vendeve të denja të punës në industri					
1	Deklarimi i numrit të punësuarve në prodhim sipas ATK/të dhënat e anketës së punës nga ASK	0.756	86.57%(2022)	80%	87%
2	Varfëria në punë në prodhim	26.6% (2020)	n/a	15%	10%
3	Numri i aksidenteve në punë në prodhim	49 (2021)	106(2024)	0%	0%
3.3 Objektivi specifik: Integrimi i grave dhe të rinjve në tregun e punës dhe biznes					
1	Përqindja e të rinjve të punësuar në prodhim në totalin e të rinjve të punësuar (%)	10.2% (2021)	11.2% 2023	13.7%	16.5%
2	Përqindja e grave në totalin e të punësuarve në prodhim (%)	15.9% (2021)	17.8% (2023)	20.7%	23.9%

Objektivi specifik 3.1. “Kualifikimi dhe certifikimi i fuqisë punëtore teknike dhe menaxherëve të ndërmarrjeve” në indikatorin” ka katër tregues, dy prej të cilëve kanë të dhëna krahasimore ndërsa për dy treguesit tjerë nuk ka të dhëna.

Treguesi 1 “Numri i institucioneve të akredituara të trajnimit për industri të prodhimit”, ka treguar trend pozitiv por mjaftë të ngadalshëm në arritjen e synimit për vitin 2026.

Treguesi -2 “Numri i standardeve të profesionit të miratuara në industrinë e prodhimit”, në vitin 2023/24, tregon trend negativ nga të dhënat bazë.

Në 2 treguesit “Përqindja e punëtorëve që marrin trajnim formal në prodhim (%)” dhe “Numri i certifikatave ISO të lëshuara në Kosovë”, mungojnë të dhënat e raportuara.

Objektivi specifik 3.2. “Promovimi i krijimit të vendeve të denja të punës në industri” në indikatorin ka tre tregues, për dy prej të cilëve ka të dhëna krahasuese ndërsa për një tregues nuk kemi të dhëna.

Treguesi 1 “Deklarimi i numrit të punësuarve në prodhim sipas ATK-së dhe të dhënat e anketës së punës nga ASK-ë”, ka tejkaluar pritshmërinë, ndërsa treguesi 2 “Varfëria në punë në

prodhim”, për arsye të mungesës së të dhënave është i përjashtuar si tregues.

Treguesi-3, “Numri i aksidenteve në punë në prodhim”, nga të dhënat e vitit 2023, ka trend negativ që do të thotë se numri i aksidenteve është në rritje dhe është larg nga synimi për vitin 2026.

Objektivi specifik 3.3. “Integrimi i grave dhe të rinjve në tregun e punës dhe biznes”, ka dy tregues.

Treguesi 1 “Përqindja e të rinjve të punësuar në prodhim në totalin e të rinjve të punësuar (%)”, dhe Treguesi 2 “Përqindja e grave në totalin e të punësuarve në prodhim (%)”, tregojnë trend pozitiv dhe premtues në arritjen e synimit të vitit 2026.

Objektivi strategjik 4: Lehtësimi i industrisë qarkore dhe të gjelbër

Qarkullimi dhe riciklimi në prodhimin e Kosovës është ende shumë i kufizuar, ndërsa mbeturinat industriale dhe ndotja janë të konsiderueshme. Efikasiteti energjetik dhe intensiv i CO2 i sektorit të prodhimit të Kosovës është përmirësuar, por ende mbetet mbrapa vendeve krahasuese të BP6, gjë që kjo ndodh për shkak të gjenerimit të ulët të energjisë nga burimet e ripërtëritshme.

Vlera bazë e të dhënave gjatë hartimit të strategjisë ishte viti 2019, ndërsa vlera e fundit e disponueshme është viti 2022, trendi i Emetimet e CO2 për njësi VShP, është në rënie dhe synimi i përkohshëm i vitit 2026 është arritur në vitin 2022 në 0.58 (kg/euro).

Tabela 4. Objektivi strategjik 4: Lehtësimi i industrisë qarkore dhe të gjelbër dhe treguesit e veprimit

4 Nr.	Objektivat strategjike dhe specifike, treguesit dhe veprimet	Vlera bazë	Vlera e fundit (aktuale)	Synimi i përkohshëm ë2026]	Synimi i vitit të fundit ë2030]
4	Objektivi strategjik: Lehtësimi i industrisë qarkore dhe të gjelbër				
1	Emetimet e CO2 për njësi VShP (kg/Euro)	0.77 (2019)	0.58 (2022)	0.6	0.3
4.1	Objektivi specifik: Mbështetje për ndërmarrjet për të rritur riciklimin dhe qarkullimin në prodhim				
1	Vlera e shtuar bruto në sektorët që lidhen me ekonominë qarkore (% e BPV-së totale)	0.80% (2020)	n/a	1.0%	1.3%
2	Përdorimi i materialit të ricikluar (%)	n/a	n/a	Mesatarja e PB	Mesatarja e BP
4.2	Objektivi specifik: Mbështetja e prodhimit dhe konsumit të produkteve të gjelbra				
1	Përqindja e tregut nga produktet miqësore me mjedisin	n/a	n/a	Mesatarja e BP	Mesatarja e BP
2	Përqindja e qytetarëve që blejnë shpesh produkte miqësore me mjedisin	n/a	n/a	Mesatarja e BP	Mesatarja e BP

4.3	Objektivi specifik: Mbështetja e përmirësimit teknologjik me fokus në rritjen e efikasitetit të energjisë dhe materialeve				
1	Intensiteti i energjisë në prodhim (Toe/mil. EUR)	339 (mes. 2018-2020)	245.6 (2022)	250 (2026)	150 (2030)

Objektivi specifik 4.3 “Mbështetja e përmirësimit teknologjik me fokus në rritjen e efikasitetit të energjisë dhe materialeve” ka Treguesin “Intensiteti i energjisë në prodhim (Toe / mil VShP)” ka një ulje të dukshme nga viti 2021 sa ishte 311 (Toe / mil VShP), në vitin 2022 kemi 245.6 (Toe / mil VShP), vlerë e cila tejkalon synimin për vitin 2026.

Për Treguesit e Objektivit specifik 4.1 ”Mbështetje për ndërmarrjet për të rritur riciklimin dhe qarkullimin në prodhim” dhe Objektivit specifik 4.2 “Mbështetja e prodhimit dhe konsumit të produkteve të gjelbra” nuk ka të dhëna krahasuese.

Objektivi strategjik 5: Maksimizimi i përfitimit të brendshëm

Prodhimi i Kosovës karakterizohet me zinxhirë të vlerës të dobët vendore dhe shfrytëzim joefikas të burimeve ekzistuese natyrore gjë e cila rezulton në humbje të ndryshme të vlerës. Ndër të tjera, kjo është për shkak të prodhimit me teknologji të ulët, përpunimit të kufizuar të burimeve natyrore ekzistuese dhe inputeve të importuara (materiale dhe shërbime) për prodhim në vend që t'i sigurojë ato në vend e tyre.

VShP/Outputi i prodhimit, është në kompetencë të ASK për tu siguruar, deri në këtë periudhë raportuese nuk ka ndonjë të dhënë që mundë të i referohemi.

Tabela 5. Objektivi strategjik 5: Maksimizimi i përfitimit të brendshëm dhe treguesit e veprimit

5 Nr.	Objektivat strategjike dhe specifike, treguesit dhe veprimet	Vlera bazë	Vlera e fundit (aktuale)	Synimi i përkohshëm ë2026]	Synimi i vitit të fundit ë2030]
5	Objektivi strategjik: Maksimizimi i përfitimit të brendshëm				
1	VShP/Outputi i Prodhimit (Prodh/output)	n/a	n/a	n/a	n/a
5.1	Objektivi specifik: Rritja e pjesëmarrjes së inputeve vendore në prodhim				
1	Vlera e importit të produkteve të ndërmjetme (klasifikimi BEC) si pjesë e VShP	169.1% (2020)	223 % (2023)	133.1%	109.1%
5.2	Objektivi specifik: Përmirësimi i inovacionit të produktit drejt prodhimit me vlerë më të lartë të shtuar				
1	Përqindja e firmave që prezantuan një produkt/shërbim të ri	26.9% (2019)	n/a	32% (2026)	40% (2023)
5.3	Objektivi specifik: Forcimi i lidhjeve me ofruesit e shërbimeve vendase të lidhura me industrinë				
1	Shërbimet e brendshme të blera nga industrinë	n/a	n/a	Mesatarja e BP	Mesatarja e BP

Objektivi specifik 5.1 “Rritja e pjesëmarrjes së inputeve vendore në prodhim” ka vetëm një tregues “Vlera e importit të produkteve të ndërmjetme (klasifikimi BEC) si pjesë e VShP” i cili është larg synimeve bazuar në të dhënat e BQK-së.

IV. RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE

IV.1 Problemet dhe rreziqet

Gjatë monitorimit të planit të veprimit të dhënat tregojnë se disa nga aktivitetet nuk janë realizuar, ose janë realizuar pjesërisht, në këtë rast institucionet përgjegjëse për zbatim të aktiviteteve nuk i kanë inkuorporuar aktivitetet në planet e tyre vjetore.

Rrezik i zakonshëm në mos zbatim të aktiviteteve për vitin 2023 dhe 2024, bazuar në takimet dhe diskutimet e institucioneve përgjegjëse për zbatim të aktiviteteve, vlerësohet të jetë mungesa e mjeteve financiare dhe plotësim ndryshimi i kornizës ligjore konkretisht të disa aktivitetet të MFPT, ku kërkohet plotësim ndryshim i ligjeve.

Mos përfshirja e aktiviteteve të planifikuara të planit të veprimit të strategjisë në planet e punës të institucioneve përgjegjëse, është shqetësim i ngritur edhe në raportin vjetor të vitit 2023, mirë po prapë një numër i institucioneve, disa aktivitetet të planit të veprimit të strategjisë nuk i kanë inkuorporuar në planet e punës. Mos inkuorporimi i aktiviteteve të strategjisë në planet e punës ka ndikuar në mos zbatim të disa aktiviteteve dhe mos zbatim të arritjes së objektivave specifike dhe strategjike.

Ndër pengesat në analizën e ndikimit të masave për arritjen e objektivave strategjike është mungesa apo vonesa e publikimi të dhënave të treguesve, ku zakonisht të dhënat e vitit paraprak nuk publikohen në TM1 të vitit vijues.


IV.2 Hapat e ardhshëm

Çdo objektiv strategjik paraqet sfida unike që kërkojnë vëmendje të përqendruar, kërkohet që vonesat në zbatimin e aktiviteteve apo ndryshimi i aktiviteteve të kenë bazë dhe arsyeshmëri nga institucionet përgjegjëse për zbatim të aktiviteteve.

Anëtarët e organit koordinues ndërministror për monitorimin, vlerësimin e rregullt, kryerjen e rishikimit të përkohshëm dhe vlerësimin përfundimtar të SZHIMB-2030 dhe Planin e Veprimit 2023-2025, duhet të kujdesen që aktivitetet e planifikuara për zbatim nga institucioni të cilin e përfaqësojnë, të hyn në planin e veprimit të punës dhe të nxjerrin rekomandimet për hapat e ardhshëm konkretisht për hartimin e planit të veprimit 2026-2028.

ASK, të përpunoj dhe ofroj të dhënat për treguesit e objektivave strategjike dhe specifike, në kohë për raportim (të dhënat për vitin 2025 të sigurohen nga ASK, deri në shkurt të vitit 2026).

Ndër hapat e ardhshëm të zbatimit të aktiviteteve kryesore, ku nga anëtarët e institucioneve përgjegjëse kërkohet të shikohen mundësitë e zbatimit të aktiviteteve janë:



Objektivi 1, objektivi specifik 1.1, “Hartimi i studimit të fizibilitetit për krijimin e Bankës Zhvillimore të Kosovës” dhe aktiviteti 1.1.2. “Plotësimi i kuadrit rregullator për tregun e letrave me vlerë të korporatave dhe instrumenteve tjera të ngjashme të financimit”, nuk janë realizuar edhe pse janë planifikuar për zbatim në vitin 2024, MF dhe BQK të analizojnë nëse këto aktivitete mundë të realizohen apo të fillojnë së realizuari në vitin 2025.

Aktiviteti 1.1.3. “Krijimi i Zyrës Këshilluese për Qasje në Financa”, është në proces, KIESA të kujdeset për krijimin e zyrës.

Objektivi specifik 1.2, aktiviteti 1.2.8 “Ofrimi i lehtësirave në tatim në të ardhurat e korporatave për investime strategjike”, ky aktivitet nuk është realizuar edhe pse është planifikuar për zbatim në vitin 2023. nga MFPT, si aktivitet është kërkuar të largohet nga plani i veprimit, të konsultohet edhe njëherë MFPT nëse mundë të realizohet në vitet në vijim deri në vitin 2025.

Objektivi specifik 1.3, aktiviteti 1.3.5 “Krijimi i modeleve të marrëveshjeve për mbrojtjen e të dhënave bazuar në legjislacionin në fuqi për t’ju shërbyer kompanive prodhuese dhe bizneseve tjera”, ky aktivitet të kalon në aktivitet të fushatës informative, përmes realizimit të “Fokus Grupeve” të sektorit të industrisë prodhuese/përpunuese.

Aktiviteti 1.3.1 “Organizimi i ekspozitës digjitale për industrinë e prodhimit”, nga MINT të merren hapat konkret për realizim në vitin 2025, ndërsa aktiviteti 1.3.3 “Ofrimi i objekteve publike për hapje të qendrave të inovacionit digjital në shërbim të industrisë”, nga MINT të shikohen arsyet dhe të analizohet situata për realizimin e këtij aktiviteti gjatë vitit 2025.


Objektivi specifik 1.4, aktiviteti 1.4.2 “Ofrimi i mbështetjes financiare për trupat për vlerësim të konformitetit (TVK) për të përmirësuar pajisjet e tyre dhe për të ndërtuar kapacitete operacionale “, të analizohet dhe të shikohet nëse ekziston mundësia e realizimit në vitin 2025.

Aktiviteti 1.4.3 “Hartimi i planit të veprimit që parashtron hapat që do të ndërmerren nga Drejtoria e Akreditimit të Kosovës (DAK) për të përmbushur kërkesat për anëtarësim të plotë në organizatën Evropiane për Akreditim (EA)”, të punohet në hartimin e planit të veprimit për përmbushjen e kërkesave për anëtarësim në EA.

Objektivi 2, objektivi specifik, 2.3, aktiviteti 2.3.2 “Përmirësimi i regjimit tarifor të importit për të ofruar mbrojtje për produkte strategjike”, ky aktivitet të analizohet dhe të shikohet nëse ka mundësi për përmirësim të regjimit tarifor, duke respektuar MTL dhe marrëveshjet tjera në fuqi dhe duke analizuar praktikatat e vendeve tjera.

Aktiviteti 2.1.6 “Kryerja e një analize për të vlerësuar ndikimin e aktiviteteve për promovim të eksporteve” të përfundohet dhe të publikohet analiza nga KIESA

Aktiviteti 2.1.7 “Krijimi i programi për mentorim për të lidhur anëtarët e diasporës së Kosovës me përvojë në prodhim me eksportuesit potencial”, dhe Aktiviteti 2.1.9 “Angazhimi i anëtarëve të diasporës për të ndihmuar eksportet në industri në kuadër të Programit për Diplomaci Qytetare” MPJD nuk ka raportuar deri më tani për këto aktivitete andaj kërkohet që këto aktivitete të realizohen.



Aktiviteti 2.2.3 “Mbështetje për krijim të brendeve të jashtme për lehtësimin e depërtimit të ndërmarrjeve prodhuese në tregjet e reja të eksportit, në bashkëpunim me partnerët e jashtëm biznesor dhe të diasporës”, KIESA nuk ka raportuar deri më tani për këtë aktivitet.

Aktiviteti 2.3.2 “Përmirësimi i regjimit tarifor të importit për të ofruar mbrojtje për produkte strategjike”, MFPT të ndërmerr hapa për realizimin e këtij aktiviteti.

Aktiviteti 2.3.4 “Ofrimi i granteve për të rinj, përmes qendrave të inovacionit, që të zhvillojnë projekte promovuese kreative për konsumin e produkteve vendore” dhe aktiviteti 2.3.5 “Lansimi i fushatës informuese për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve për të blerë produkte vendore”, KIESA të ndërmerr hapa për realizimin e këtyre aktiviteteve.

Objektivi 3, objektivi specifik 3.1, aktiviteti 3.1.4 “Krijimi i programit të punësimit në prodhim në kuadrin e Masave Aktive të Tregut të Punës” (masat: praktikë në vend të punës dhe subvencionim i pagës), Agjencia e Punës të analizoj aktivitetet e strategjisë dhe të inkorporoj në aktivitetet apo programet e planifikuara. Aktiviteti 3.1.5 “Krijimi i kredit-skemës për ngritje të shkathtësive në treg të punës” i rekomandohet Agjencia e Punësimit që të zhvilloj skemat në koordinim me ASHI.

Objektivi specifik 3.3, aktiviteti 3.3.1 “Organizimi i javës së grave në industri” KIESA, duhet të zgjeroj aktivitetin tashmë tradicional “Gratë në Biznes”, duke organizuar konferenca, duke prezantuar storie të suksesit të grave afariste Kosovare etj.

Objektivi 4, objektivi specifik 4.3, aktiviteti 4.3.1 “Zhvillimi i programit për investime në teknologji të gjelbër në industrinë prodhuese”, MINT konkretisht Departamenti i Industrisë të konsultohet me BERZH për mundësinë e zbatimit të aktivitetit.

Aktiviteti 4.2.4 “Inkorporimi i kriterëve të prokurimit të gjelbër në industrinë e ushqimit, tekstilit dhe mobilerisë”, pritet që ky aktivitet të realizohet nga MFPT.

Objektivi 5, objektivi specifik 5.2, aktiviteti 5.2.2 “Reduktimi i tatimit në të ardhurat e korporatave për kompanitë e mëdha prodhuese që investojnë në entitete të përzgjedhura inovative”, nga MFPT, si aktivitet është kërkuar të largohet nga plani i veprimit, të konsultohet edhe njëherë MFPT nëse mundë të realizohet në vitet në vijim deri në vitin 2025.

Aktiviteti 5.1.1 “Krijimi i tabelave input-output për të kuptuar strukturën e inputeve të përdorura në industri”, ASK duhet të përpunoj këto të dhëna dhe të krijoj tabelat input-output.

Aktiviteti 5.2.1 “Ndarja e çmimit për inovacion në produkte prodhuese”, ky aktivitet pritet të realizohet nga Departamenti i Inovacionit.

Aktiviteti 5.2.4 “Mbështetja për institucione të arsimit të lartë për krijim të programeve ekzekutive të inovacionit në industri”, ky aktivitet të realizohet nga MASHT-i.

Aktiviteti 5.3.2 “Mbështetja e masës preventive për mirëmbajtjen e makinerive në ndërmarrje prodhuese”, ky aktivitet të realizohet nga KIESA.

ANEKS 1. Zbatimi i aktiviteteve të SZHIMB – 2030, Plani i Veprimit 2023 – 2025, për periudhën (Korrik 2023 – Dhjetor 2024)

Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Institucioni udhëheqës	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Statusi i progresit	Sqarim i shkurtër i progresit
Objektivi strategjik: Zgjerimi i prodhimit industrial							
Objektivi specifik 1.1: Lehtësimi i qasjes në financa për prodhuesit vendor							
1.1.1	Hartimi i studimit të fizibilitetit për krijimin e Bankës Zhvillimore të Kosovës	TM3 2024	MINT dhe ME	MINT dhe ME	Studimi i fizibilitetit i finalizuar	E perealizuar	Aktivitet që ende nuk ka filluar
1.1.2	Plotësimi i kuadrit rregullator për tregun e letrave me vlerë të korporatave dhe instrumenteve tjera të ngjashme të financimit	TM4 2024	MFPT dhe BQK	MFPT dhe BQK	Ligj për shërbimet alternative të financimit	E perealizuar	Aktivitet që ende nuk ka filluar
1.1.3	Krijimi i Zyrës Këshilluese për Qasje në Financa	TM1 2024	MINT (KIESA)	MINT (KIESA)	Zyra këshilluese e themeluar dhe funksionale	E realizuar pjesërisht / në proces	Në proces të inicimit të hartimit të akteve nënligjore nga Ligji i Investimeve të Qëndrueshme. Draft rregullorja për strukturimin e KIESA-s është në shqyrtim.
Objektivi specifik 1.2: Rritja e investimeve në prodhim							
1.2.1	Hartimi i ligjit për Fondin Sovran	TM4 2023	ZKM	ZKM	Ligji për Fondin Sovran i përfunduar dhe miratuar	E realizuar	I miratuar më 15 dhjetor në Kuvendin e Kosovës
1.2.2	Hartimi i akteve nënligjore që derivojnë nga ligji i ri për parqet industriale dhe teknologjike	TM2 2024	MINT (Departamenti i Industrisë dhe KIESA)	MINT (Departamenti i Industrisë dhe KIESA)	5 akte nënligjore të finalizuara dhe aprovuara	E realizuar	Janë hartuar 5 akte nënligjore që derivojnë nga Ligji për Parqet Industriale dhe Teknologjike, katër (4) nga ato janë miratuar.

1.2.3	Hartimi i studimit që e vlerëson ndikimin e parqeve industriale aktuale në krijim të vendeve të punës, eksport dhe zhvillim ekonomik	TM4 2023	MINT-KIESA	MINT (KIESA, Departamenti i Industriisë dhe GIZ (EP)	Studimi që vlerëson ndikimin e parqeve aktuale i përfunduar	E realizuar	Është hartuar studimi lidhur me ndikimin e parqeve industriale aktuale në krijim të vendeve të punës, eksport dhe zhvillim ekonomik
1.2.5	Krijimi i parkut industrial të gjelbër	TM4 2024 TM4 2025	MINT (KIESA)	MINT (KIESA)	Përfundimi i parkut industrial të gjelbër	E realizuar pjesërisht / në proces	Është themeluar parku industrial 2 në Drenas. Është përgatitur projekti dhe janë zhvilluar procedurat për kontraktimin e operatorit ekonomik për ndërtim të infrastrukturës, i cili është kontraktuar dhe ka filluar punimet.
1.2.6	Përgatitja e videove promovuese për storiet e suksesit të IHD-ve në Kosovë	TM4 2023 TM4 2024 TM4 2025	MINT-KIESA	MINT (KIESA)	Videot e promovimit të përfunduara	E realizuar	Gjatë vitit 2023, janë realizuar video për promovimin e sektorëve me potencial dhe storiet e suksesit në ata sektor. Gjatë vitit 2024, është realizuar video për promovimin e turizmit dimëror
1.2.7	Hartimi i ligjit që përcakton statusin e kampionëve kombëtarë	TM4 2024	MINT dhe ME	MINT dhe ME	Ligji për kampionët kombëtarë i përfunduar dhe miratuar	E realizuar pjesërisht / në proces	Në koncept dokumentin për fondin sovran, rekomandohet që puna në këtë Ligj të fillojë pas miratimit të Ligjit për Fondin Sovran. Statusi i kampioneve kombëtarë - Sipërmarrjet kampione janë trajtuar në Projektligjin për Fondin Sovran të Republikës së Kosovës
1.2.8	Ofrimi i lehtësirave në tatim në të ardhurat e korporatave për investime strategjike	TM3 2023	MFPT	MFPT dhe ZKM	Ligji për tatimin në të ardhurat e korporatave i ndryshuar me pushimin tatimor të përfshirë	E përealizuar	Plotësim ndryshimi i ligjit për TAP është në Planin legjislativ për TM4 2025.
1.2.9	Hartimi i programit për promovim të investimeve (dokument strategjik)	TM3 2024	MINT (Departamenti për investime strategjike)	MINT (Departamenti për investime strategjike)	Programi për promovim të investimeve i finalizuar dhe miratuar	E realizuar pjesërisht / në proces	Është duke u hartuar Strategjia Kombëtare për Investime

Objektivi specifik 1.3: Përshpejtimi i digjitalizimit në prodhim

1.3.1	Organizimi i ekspozitës digjitale për industrinë e prodhimit	TM3 2024 TM3 2025	MINT (KIESA, Departamenti i Inovacionit dhe Departamenti i Industrisë)	MINT (KIESA, Departamenti i Inovacionit dhe Departamenti i Industrisë)	Nga një ekspozitë secilin vit me të paktën 90 kompani pjesëmarrëse	E porealizuar	Planifikohet në vitin 2025
1.3.2	Ofrimi i kuponëve (me bashkëfinancim) për transformim digjital dhe siguri kibernetike	TM3 2024 TM3 2025	MINT (KIESA) dhe BERZH	MINT (KIESA) dhe BERZH	150 përfitues të skemës së kuponëve për digjitalizim	E realizuar	Janë përkrahur 215 kompani në vitin 2024
1.3.3	Ofrimi i objekteve publike për hapje të qendrave të inovacionit digjital në shërbim të industrisë	TM4 2024	MINT (KIESA dhe Departamenti i Inovacionit)	MINT (KIESA dhe Departamenti i Inovacionit)	Dy qendra të inovacionit digjital të themeluara	E porealizuar	Në vitin 2024, nuk ka pasur hapje të qendrave të Inovacionit në objektet publike
1.3.5	Krijimi i modeleve të marrëveshjeve për mbrojtje të të dhënave bazuar në legjislacionin në fuqi për t'ju shërbyer kompanive prodhuese dhe bizneseve tjera	TM4 2023	MINT-DI	MINT (Departamenti i Industrisë) dhe Agjencia për Informim dhe Privatësi	Modelet e marrëveshjeve për të dhëna personale të përfunduara	E realizuar pjesërisht / në proces	Pas konsultimeve me akterët tjerë dhe bizneset është konstatuar se për arsyeje të natyrës së ndryshme të bizneseve nuk mund të krijohen modele të marrëveshjeve. Ky aktivitet kalon në Fushatë Informuese, “Informim i bizneseve me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Ligjin për mbrojtjen e sekreteve tregtare”. Në kuadër të aktiviteteve “Fokus Grupeve të Industrisë Prodhuese” që organizohen nga DI në 7 regjionet e Kosovës do të ju ofrohen bizneseve informata për ligjet në fjalë.

Objektivi specifik 1.4: Rritja e cilësisë dhe certifikimit të produkteve të njohura në nivel ndërkombëtar							
1.4.1	Krijimi i Instrumentit Nacional për Certifikim të Produkteve	TM3 2024 TM3 2025	MINT (KIESA)	MINT (KIESA)	Të paktën 30 kompani përfituese (30% të granteve për metal përpunues) në vit	E realizuar	Gjatë vitit 2024 janë përkrahur 23 biznese për certifikim të produktit, të cilat janë duke i realizuar projektet. Buxheti dhe planifikimet kanë qenë deri në 30 biznese për t'u përkrahur, mirëpo nuk ka pasur aplikime të suksesshme.
1.4.2	Ofrimi i mbështetjes financiare për trupat për vlerësim të konformitetit (TVK) për të përmirësuar pajisjet e tyre dhe për të ndërtuar kapacitete operacionale	TM4 2024	MINT (Departamenti i Industrisë dhe KIESA)	MINT (Departamenti i Industrisë dhe KIESA)	6 laboratorë testues të mbështetur në vit	E realizuar pjesërisht / në proces	Është hartuar draft skema, për dy komponentet: përkrahja e laboratorëve testues dhe të Trupave Certifikuese.
1.4.3	Hartimi i planit të veprimit që parashtron hapat që do të ndërmerren nga Drejtoria e Akreditimit të Kosovës (DAK) për të përmbushur kërkesat për anëtarësim të plotë në organizatën Evropiane për Akreditim (EA)	TM4 2023	MINT-DAK	MINT (Drejtoria e Akreditimit të Kosovës)	Plani i veprimit i përfunduar	E realizuar pjesërisht / në proces	Janë identifikuar hapat që duhet të ndërmerren për anëtarësim në EA dhe aktualisht DAK po punon në përmbushjen e këtyre veprimeve. Veprimet në vijim: 1. Rishikimi i organizimit funksional, 2. Rishikimi i kornizës ligjore, 3. Pasurimi i listës së eksperteve/vlerësuesve, 4. Fuqizimi i këshillit profesional dhe atij të akreditimit 5. ngritja e skemave të reja të akreditimit.
1.4.4	Hartimi i ligjit për mbikëqyrjen e përputhshmërisë së produkteve në treg	TM4 2023	MINT-DI	MINT (Departamenti i Industrisë)	Ligji për mbikëqyrjen e përputhshmërisë së produkteve në treg i miratuar	E realizuar pjesërisht / në proces	Është hartuar Projekt-Ligji për Inspektimin e Përputhshmërisë së Produkteve. Për ta finalizuar këtë ligj është kërkuar përkrahje nga projekti UNDP-së për angazhimin e një eksperti me përvojë në praktikën e BE-së.
1.4.5	Hartimi i akteve nënligjore që derivojnë nga ligji për mbikëqyrjen e përputhshmërisë së produkteve në treg	TM4 2024	MINT (Departamenti i Industrisë)	MINT (Departamenti i Industrisë)	Aktet nënligjore të finalizuara dhe aprovuara	E përcaktuar	Pas miratimit të Ligjit, do të fillohet me hartimin e akteve nënligjore për mbikëqyrjen e përputhshmërisë së produkteve në treg

1.4.6	Hartimi i akteve nënligjore që derivojnë nga ligji për siguri të përgjithshme të produkteve	TM4 2024	MINT (Departamenti i Industrisë)	MINT (Departamenti i Industrisë)	3 akte nënligjore të finalizuar dhe aprovuara	E realizuar pjesërisht / në proces	Janë hartuar dhe janë përcjellë për miratim: UA për mënyrën e funksionimit të sistemit të shkëmbimit të shpejtë të informacionit dhe format e njoftimit për produktet e rrezikshme; UA për njoftim në lidhje me produktet e vendosura në tregut të cilat janë të rrezikshme për konsumatorët.
1.4.7	Organizmi i punëtorive për zbatimin e legjislacionit teknik të infrastrukturës së cilësisë dhe standardeve mbështetëse	TM2 2023 TM2 2024 TM2 2025	MINT-DI	MINT (Departamenti i Industrisë), GIZ (EP) dhe shoqatat sektoriale	3 punëtori të organizuara me biznese çdo vit	E realizuar	Janë realizuar 3 takime me bizneset
1.4.8	Takime informuese me biznese për themelimin e trupave certifikuese për grupe të caktuara të produkteve jo ushqimore	TM2 2023 TM2 2024 TM2 2025	MINT-DI-KIESA	MINT (Departamenti i Industrisë dhe KIESA)	7 takime regjionale të realizuara në vit me rreth 700 biznese pjesëmarrëse	E realizuar pjesërisht / në proces	Janë realizuar 2 punëtori me përkrahje të Projektit Regjional të GIZ për fushat: 1. Pajisje elektrike dhe elektronike 2. Sigurinë e makinerive
1.4.9	Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit për të promovuar dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit në lidhje me garancinë e produktit	TM4 2024 TM4 2025	MINT (Departamenti për mbrojtjen e konsumatorit)	MINT (Departamenti për mbrojtjen e konsumatorit)	700 mijë konsumatorë të informuar për të drejtat e garancisë së produktit	E realizuar	Vetëm gjatë vitit 2024, janë shpërndara rreth 900 mijë mesazhe tel. dhe 15 mijë kartolina dhe fletëpalosje për vetëdisimin e konsumatorëve nëpër komuna.
Objektivi strategjik: Reduktimi i deficitit tregtar industrial							
Objektivi specifik 2.1: Mbështetja e ndërmarrjeve për të shfrytëzuar potencialin e tyre të eksportit							
2.1.1	Zgjerimi i dritares së eksportit në kuadër të FKGK	TM4 2024	MFPT	Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) dhe MFPT	300 kompani përfituese të produkteve financiare për eksport të mbështetura nga fondi	E realizuar	Kapitali i përdorur për dritaren e eksportit është në kuadër të projektit me Bankën Evropiane të Investimeve.

2.1.2	Krijimi i Qendrës së Informacioneve për Tregun e Eksportit (EMIC)	TM3 2024	MINT (KIESA)	MINT (KIESA)	Qendra e Informacionit për Tregun e Eksportit e themeluar dhe funksionale	E realizuar pjesërisht / në proces	Në proces të inicimit të hartimit të akteve nënligjore nga Ligji i Investimeve të Qëndrueshme. Draft rregullorja për strukturimin e KIESA-s është në shqyrtim
2.1.3	Organizimi i misioneve të shitjeve jashtë për kompanitë e gatshme për eksport në sektorë specifik	TM4 2023 TM4 2024 TM4 2025	MINT(KIESA)	MINT (KIESA)	Të paktën 500 ndërmarrje prodhuese të përkrahura për pjesëmarrje në panairë	E realizuar	Gjatë vitit 2024 janë realizuar 17 panairë ndërkombëtare në të cilat janë përkrahur rreth 180 biznese të sektorëve të ndryshëm.
2.1.4	Identifikimi i klientëve potencialë të ndërmarrjeve në tregjet e huaja dhe organizimi i vizitave për blerje brenda vendit	TM3 2024 TM3 2025	MINT (KIESA)	MINT (KIESA)	5 vizita brenda vendit të organizuara në vit	E realizuar	Janë realizuar 5 vizita nga blerës potencial të huaj tek kompanitë kosovare eksportuese të sektorëve të ndryshëm (Suedia, Turqia, Danimarka, Anglia dhe Gjermania)
2.1.5	Organizimi i takimeve rajonale B2B ndërmjet furnizuesve (“input suppliers”) vendas dhe rajonalë për të krijuar mundësi lidhjeje	TM3 2023 TM3 2024 TM3 2025	MINT(KIESA)	MINT (KIESA), GIZ (EP) dhe shoqatat sektoriale	3 takime B2B të realizuara dhe së paku 100 ndërmarrje pjesëmarrëse	E realizuar	Janë realizuar forume ekonomike me vendet si Kroacia, Hungaria, Sllovenia, Greqia, Malta dhe Gjermania, si dhe janë organizuar takime B2B mes bizneseve Kosovare dhe bizneseve nga shtetet e lartë cekura. Do të vazhdohet me organizime të ngjashme edhe gjatë vitit 2025. Po ashtu pritet që të organizohen sesionet informuese me bizneset e diasporës në vende të ndryshme. Në këto aktivitete janë përkrahur 165 ndërmarrje të Kosovës në organizimin e takimeve B2B.
2.1.6	Kryerja e një analize për të vlerësuar ndikimin e aktiviteteve për promovim të eksporteve	TM4 2023 TM4 2024 TM4 2025	MINT (KIESA)	MINT (KIESA)	Analiza e përfunduar çdo vit	E realizuar pjesërisht / në proces	Janë realizuar anketa me kompanitë e Kosovës të sektorëve të ndryshëm pjesëmarrëse në aktivitetet ndërkombëtare

2.1.7	Krijimi i programit për mentorim për të lidhur anëtarët e diasporës së Kosovës me përvojë në prodhim me eksportuesit potencial	TM4 2024 TM4 2025	MPJD	MPJD	Programi i krijuar	E perealizuar	Nuk kanë raportuar nga MPJD
2.1.8	Plotësimi i katalogut (regjistrin) të eksportuesve të Kosovës	TM4 2024	MINT (KIESA)	MINT (KIESA)	Katalogu i plotësuar	E realizuar	KIESA disponon një listë të top eksportuesve të gjeneruar në bashkëpunim me ATK
2.1.9	Angazhimi i anëtarëve të diasporës për të ndihmuar eksportet në industri në kuadër të Programit për Diplomaci Qytetare	TM4 2024 TM4 2025	MPJD dhe MINT	MPJD dhe MINT (KIESA)	Hartimi i Programit	E perealizuar	Nuk kanë raportuar
Objektivi specifik 2.2: Diversifikimi i tregjeve të eksportit							
2.2.1	Përgatitja e analizës për identifikimin e listës së produkteve prodhuese strategjike për eksport	TM4 2023	MINT-DT	MINT/Departamenti I Tregtisë dhe Departamenti I industrisë	Analiza për produktet strategjike të eksportit e përfunduar	E realizuar	Është finalizuar Analiza “Identifikimi i produkteve me potencial për eksport dhe zëvendësim të importit”
2.2.2	Negocimin e tri marrëveshjeve tregtare me fushëveprim të pjesshëm	TM4 2025	MINT-DT	MINT (Departamenti i Tregtisë)	3 marrëveshje tregtare me fushëveprim të pjesshëm të përfunduara	E realizuar	Është nënshkruar Marrëveshja e EFTA-s. Është negociuar zbatimi i Marrëveshjes tregtare me Anglinë.
2.2.3	Mbështetje për krijim të brendeve të jashtme për lehtësimin e depërtimit të ndërmarrjeve prodhuese në tregjet e reja të eksportit, në bashkëpunim me partnerët e jashtëm biznesor dhe të diasporës	TM3 2024	MINT (KIESA)	MINT (KIESA)	5 brende të mbështetura	E perealizuar	Nuk kanë raportuar

Objektivi specifik 2.3: Zëvendësimi i importit të produkteve të ndërmjetme dhe përfundimtare me prodhime vendor dhe promovimin e produkteve vendore

2.3.1	Përgatitja e analizës për të identifikuar produktet finale të importuara me potencial për t'u zëvendësuar	TM3 2024	MINT-DT	MINT (Departamenti i Tregtisë)	Analiza e finalizuar	E realizuar	Analiza e përfunduar
2.3.2	Përmirësimi i regjimit tarifor të importit për të ofruar mbrojtje për produkte strategjike	TM4 2023	MFPT	MINT (Departamenti i Tregtisë), MFPT dhe Doganat e Kosovës	Regjimi tarifor për importe i përditësuar	E përealizuar	Sipas MFPT, ky aktivitet mbase mund të realizohet, por që duhet pasur gjithnjë parasysh që kemi MTL tjera në fuqi që nuk duhet të ndikohen. Gjithashtu edhe hapat e ndërmarra në këtë drejtim duhet të jenë në linjë me praktikën e BE-së. Ende nuk ka filluar ky aktivitet
2.3.3	Përfshirja e një marzhe preferenciale kalimtare në prokurim publik për produktet vendore (shënim: nuk vlen për produktet me origjinë nga BE-ja, CEFTA, SHBA-të dhe EFTA)	TM4 2024	MFPT	MFPT dhe KRPP	Ligji i prokurimit i ndryshuar për ta përfshirë preferencën	E realizuar pjesërisht / në proces	Është në plan legjislativ për vitin 2025 dhe drafti i përfunduar gjendet në Kabinet
2.3.4	Ofrimi i granteve për të rinj, përmes qendrave të inovacionit, që të zhvillojnë projekte promovuese kreative për konsumin e produkteve vendore	TM1 2024	MINT (KIESA)	MINT (KIESA) dhe qendrat e inovacionit	10 përfitues nga grup-mosha e re (të paktën gjysma gra)	E përealizuar	Nuk është raportuar për këtë aktivitet
2.3.5	Lansimi i fushatës informuese për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve për të blerë produkte vendore	TM2 2024 TM2 2025	MINT (KIESA)	MINT (KIESA)	1 milionë qytetarë të informuar	E përealizuar	Nuk është raportuar për këtë aktivitet

2.3.6	Hartimi i politikës tregtare (programit për tregti)	TM4 2023	MINT-DT	MINT (Departamenti i Tregtisë)	Programi për tregti i përfunduar	E realizuar pjesërisht / në proces	Grupi Punues në bashkëpunim me Departamentin e Tregtisë është duke punuar në hartimin e dokumentit/programit për Politika Tregtare.
Objektivi strategjik 3: Gjenerimi i punësimit më të mirë dhe gjithëpërfshirës							
Objektivi specifik 3.1: Kualifikimi dhe certifikimi i fuqisë punëtore teknike dhe menaxherëve të ndërmarrjeve							
3.1.1	Zbatimi i hulumtimit gjithëpërfshirës për të identifikuar aftësitë që mungojnë në tregun e punës së industrisë dhe për të kuptuar sfidat e punëdhënësve në gjetjen e punëtorëve të kualifikuar	TM4 2023	MINT-DI	MINT (Departamenti i Industrisë), USAID (PSWD) dhe GIZ	Raporti hulumtues i përfunduar	E realizuar	1. Hulumtimi është përfunduar në Dhjetor të vitit – 2024.
3.1.2	Ofrimi i ndihmës financiare për shoqatat prodhuese për të menaxhuar këshillat sektoriale të punës	TM4 2023 TM4 2024 TM4 2025	USAID/IREX	USAID (PSWD) dhe Shoqatat sektoriale	Këshillat sektoriale të punës të krijuara dhe funksionale për sektorin e drurit, agro-përpunimit dhe një sektor i tretë industrial të TIK-ut, dhe funksionimi i sektorit të energjisë së ripërtërishme.	E realizuar	Këshillat Sektoriale të Fuqisë Punëtore janë funksionale për sektorin e teknologjisë të informacionit dhe komunikimit (TIK), përpunimit të drurit dhe agrobiznesit. Në vitin 2024, PSWD ka themeluar Këshillin e Fuqisë Punëtore edhe në sektorin e energjisë së ripërtërishme. Po ashtu është hartuar edhe Draft-Rregullorja e funksionimit të Këshillave.
3.1.3	Hartimi i ligjit për këshillat industriale	TM3 2024	USAID (PSWD)	MFPT, MINT dhe USAID (PSWD)	Ligji për këshillat industrial i përfunduar dhe miratuar	E realizuar pjesërisht / në proces	Nuk është punuar në këtë Ligj. Kjo pasi që Këshillat industrial janë të krijuara në kuadër të OEK. Do të përfshihen në Ligjin e OEK

3.1.4	Krijimi i programit të punësimit në prodhim në kuadrin e Masave Aktive të Tregut të Punës (masat: praktikë në vend të punës dhe subvencionim i pagës)	TM4 2023 TM4 2024 TM4 2025	MFPT - Agjencia e Punësimit	MPFT (Agjencia e Punësimit)	Të paktën 1,200 përfitues të programit të punësimit në prodhim secilin vit	E realizuar pjesërisht / në proces	Përmes projektit super puna kanë përfituar subvencione në pagë 9 mijë e 394 punëkërkues, për periudhën 6 mujore. Mungojnë të dhënat sa kanë përfituar në sektorin prodhues. Nuk kanë raportuar nga Agjencia e Punësimit.
3.1.5	Krijimi i kredit-skemës për ngritje të shkathtësive në treg të punës	TM4 2024 TM4 2025	MFPT (Agjencia e Punësimit) dhe ASHI	MFPT (Agjencia e Punësimit) dhe ASHI	1,300 kandidatë të trajnuar dhe certifikuar (të paktën gjysma gra)	E realizuar pjesërisht / në proces	Nuk kanë raportuar nga Agjencia e Punësimit. Është duke e hartuar skemën për ri trajnimin e punëtorëve dhe përfshirjen e sistemit dual. Do të realizohet në 2025.
3.1.6	Mbështetje për hapjen e qendrave trajnuese të akredituara jo publike me programe për ngritje të shkathtësive në industri	TM4 2024 TM4 2025	Buxheti i Kosovës dhe WBF	MFPT dhe WBF	6 qendra trajnuese të reja të hapura	E realizuar pjesërisht / në proces	Projekti i Lux Dev , KSV/021 do t'i përkrah qendrat trajnuese private në 4 sektorë: sektori i drurit dhe mobilierisë, sektori i ushqimit dhe pijeve, energjisë së ripërtrishme dhe TIK. Njëkohësisht e kanë hartuar studimin për identifikimin e qendrave ekzistuese, si dhe rekomandimet për qendrat e reja.
3.1.7	Mbështetje për hartimin e programeve trajnuese për zhvillim të shkathtësive në industri	TM4 2023 TM4 2024 TM4 2025	USAID- MASHT	MASHTI (Autoriteti Kombëtar për Kualifikime) dhe USAID (PSWD)	15 programe trajnuese të reja të krijuara	E realizuar pjesërisht / në proces	USAID/IREX, nga thirrja e parë për grante e shpallur në vitin 2023 nga PSWD, rezultatet e pritura gjatë periudhës së zbatimit të granteve në 2024 dhe 2025 janë që do të zhvillohen 12 programe në TIK, 2 në agrobiznes dhe 3 në sektorin e përpunimit të drurit. Në total do të jenë 17 programe, nga të cilat 14 të reja dhe 3 të avancuara. Në vitin 2024/2025, janë krijuar GP, por këto programe janë ndaluar për arsye të ndalimit të fondeve nga USAID.

Objektivi specifik 3.2: Promovimi i krijimit të vendeve të denja të punës në industri							
3.2.1	Hartimi i analizës për të vlerësuar shkallën e informalitetit në punë sipas aktiviteteve të industrisë	TM4 2023	MINT-DI	MINT (Departamenti i Industrisë)	Analiza e informalitetit në industri e finalizuar	E realizuar	I përfunduar në TM4 2023
3.2.2	Përcaktimi i pragut të pagës së dinjitetshme në industri (një prag jo i detyrueshëm i të ardhurave më i lartë se paga minimale) dhe ofrimi i mirënjohjes për kompanitë që ofrojnë paga mbi pragun e përcaktuar	TM4 2023 TM4 2024 TM4 2025	MINT-DI	MINT (Departamenti i Industrisë) dhe MFPT	Paga e dinjitetshme e përcaktuar dhe ofrimi i mirënjohjeve për kompanitë	E realizuar	I përfunduar në TM4 2023
Objektivi specifik 3.3: Integrimi i grave dhe të rinjve në tregun e punës dhe biznes							
3.3.1	Organizimi i javës së grave në industri	TM4 2023 2024 2025	MINT-KIESA	MINT (KIESA)	150 gra përfituese	E realizuar	Për vitin 2024, thirrja për aplikim për pjesëmarrje në panairin e grave është përfunduar.
3.3.2	Mbështetja e qendrave të karrierës në shkolla të mesme dhe universiteteve që të krijojnë lidhje bashkëpunuese me shoqatat e industrisë	TM4 2023	MASHTI dhe MINT	MASHTI dhe MINT (Departamenti i Industrisë), Shoqatat	10 qendra të karrierës dhe Universitete të përkrahura për të krijuar memorandume bashkëpunimi me shoqatat kryesore	E realizuar	Në TM2-TM4 2023, janë themeluar 8 qendra të reja në IAAP dhe janë caktuar koordinorët për orientim në karrierë dhe koordinorët për bashkëpunim me bizneset. Gjithsej janë 24 qendra të karrierës në institucionet e AAP të cilat janë në kontakt të vazhdueshëm me biznese për rritjen e bashkëpunimit për zbatimin e mësimin praktik në biznese. Në këtë vit kemi 12 profile me të cilat po zhvillohet Mësimi Dual. Deri me 31 dhjetor 2024, me mbështetjen e MASHTI, dhe në bashkëpunim me komunat, bazuar në UA për këshilltar të karrierës, janë themeluar edhe 5 qendra të reja të karrierës në IAAP, 2 në Ferizaj, 2 në Gjilan dhe një në Gjakovë. Për të ofruar shërbime në këto qendra të reja të


							karrierës, janë trajnuar edhe 8 koordinator të rinjë për tu kualifikuar me programin kualifikues për këshilltar të karrierës.
3.3.3	Përkrahja e trajnimeve për gra dhe të rinj në vend të punës	TM3 2023 TM3 2024 TM3 2025	BERZH dhe MINT - KIESA	BERZH dhe MINT - KIESA	300 gra dhe te rinj të trajnuar 600 të rinj të trajnuar	E realizuar	186 të trajnuar, Në Janar-Qershor 2024, 30 të trajnuar. Po ashtu edhe 132 të rinjë të trajnuar.
Objektivi strategjik 4: Lehtësimi i industrisë qarkore dhe të gjelbër							
Objektivi specifik 4.1: Mbështetje për ndërmarrjet për të rritur riciklimin dhe qarkullimin në prodhim							
4.1.1	Organizimi i seminareve për ndërmarrjet prodhuese për t'i njoftuar ato me bazat e modeleve të biznesit të ekonomisë qarkore	TM4 2023 TM2 2024 TM2 2025	UNDP	MINT (Departamenti i Industrisë) dhe UNDP	5 seminare me nga 30 biznese të informuara për modelet e ekonomisë qarkore	E realizuar	Në muajin tetor janë realizuar dy takime me biznese për t'i njoftuar me programin lidhur me bazat e modeleve të biznesit të ekonomisë qarkore. Kanë marr pjesë gjithsej 30 biznese, si dhe të njëjtat janë trajnuar në modulën e tranzicionit të gjelbër.
4.1.2	Promovimi i simbiozave industriale për të lehtësuar shkëmbimin e materialeve (nën-produkteve) ose vijave të mbetjeve	TM3 2024		MINT (Departamenti i Industrisë) dhe UNDP		E realizuar	Në kuadër të promovimit të industrisë së gjelbër janë promovuar edhe simbiozat në industri. Janë shpërndarë 12 grante për biznese që promovojnë simbiozat industriale, transformimin e gjelbër dhe digjital.
4.1.3	Krijimi i dritarës për inovacion drejt ekonomisë qarkore në kuadër të fondit të inovacionit	TM4 2024 TM4 2025		MINT (Departamenti i Inovacionit dhe KIESA)		E realizuar pjesërisht / në proces	KIESA në bashkëpunim me LUXDEV ka zhvilluar skemën përkrahëse për inovacion, ju janë përkrahur gjithsej 49 biznese (34 NVM dhe 15 start-up biznese). Jo në kuadër të fondit të Inovacionit.

Objektivi specifik 4.2:							
4.2.1	Transpozimi i dispozitave përkatëse të Rregullores së BE-së për "ecolabel" në legjislacionin vendor	TM4 2025	ME	MPHJ, ME dhe MINT	Ligji për Eficiencën e Energjisë i përfunduar	E realizuar pjesërisht / në proces	Bazë për transpozimin e rregullores së BE-se për "ecolabel" në legjislacionin vendor është Ligji për Eficiencën e Energjisë. Aktualisht gjenden në fazën e draftimit të ligjit për eficiency të energjisë dhe pas miratimit të ligjit do të fillojnë procedurat për transpozimin e rregullores. Planifikohet që deri në TM4 2025 të bëhet transpozimi i rregullores për ecolabel.
4.2.2	Inkorporimi i dispozitave përkatëse të direktivës së "ecodesign" të BE-së në legjislacionin vendor	TM4 2025	ME	ME dhe MINT	Ligji për Eficiencën e Energjisë i përfunduar	E realizuar pjesërisht / në proces	Bazë për transpozimin e direktivës së BE-se për "ecodesign" në legjislacionin vendor është Ligji për Eficiencën e Energjisë. Aktualisht gjenden në fazën e draftimit të ligjit për eficiency të energjisë dhe pas miratimit të ligjit do të fillojnë procedurat për transpozimin e direktivës. Planifikohet që deri në TM4 2025 të bëhet transpozimi i direktivës për ecodesign.
4.2.4	Inkorporimi i kriterëve të prokurimit të gjelbër në industrinë e ushqimit, tekstilit dhe mobilerisë	TM4 2024	MFPT	MFPT	Kritere e inkorporuara	E përealizuar	Është aktivitet I planifikuar në CRM2 dhe MFPT kanë dhënë sinjale që do ta realizojnë. Pritet të fillon në 2025.
Objektivi specifik 4.3: Mbështetja e përmirësimit teknologjik me fokus në rritjen e efikasitetit të energjisë dhe materialeve							
4.3.1	Zhvillimi i programit për investime në teknologji të gjelbër në industrinë prodhuese	TM4 2023	BERZH	BERZH dhe institucionet financiare partnere	Së paku 80 kompani përfituese	E përealizuar	Nuk është realizuar pasi që nuk është alokuar buxheti. Ky aktivitet është modifikuar dhe janë dhënë grante për blerjen e makinerive - teknologjisë për sektorët industrial.

Objektivi strategjik 5: Maksimizimi i përfitimit të brendshëm**Objektivi specifik 5.1: Rritja e pjesëmarrjes së inuteve vendore në prodhim**

5.1.1	Krijimi i tabelave input-output për të kuptuar strukturën e inuteve të përdorura në industri	TM4 2024	ASK	ASK	Tabelat input-output të krijuara	E parealizuar	Nuk kemi pranuar inute
5.1.2	Transpozimi i dispozitave përkatëse të direktivës së BE-së për praktikën e padrejta tregtare në zinxhirin e furnizimit në industrinë ushqimore	TM4 2024	MINT (Departamenti i Tregtisë)	MINT (Departamenti i Tregtisë)	Ligji për praktikën e padrejta tregtare në zinxhirin e furnizimit me ushqime i përfunduar	E realizuar pjesërisht / në proces	Mund të theksojmë se praktikën e padrejta tregtare janë të përcaktuara në nenin 47 të Ligjit për Tregtinë e Brendshme. Gjithsesi, nëse dëshirojmë t'i trajtojmë më specifikisht, siç kërkon direktiva e BE-së për "praktikën e padrejta tregtare në marrëdhëniet biznes-biznes në zinxhirin e furnizimit me bujqësi dhe ushqim", do të ishte mirë të kontaktohej edhe Ministria e Bujqësisë. Ata gjithashtu në "Strategjinë për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural për periudhën 2022-2028" kanë një objektivi specifik në këtë drejtim (Objektivi 1.3: Përmirësimi i pozitës së fermerëve në zinxhirin e vlerës), dhe janë duke punuar në aktivitete të transpozimit të direktivave të BE-së. Andaj, konsiderojmë që është e nevojshme të mbajmë takim së bashku me MBZHR
5.1.3	Hartimi i studimit në lidhje me shfrytëzimin e burimeve natyrore për industrinë	TM4 2023	MINT-DI	MINT	Studimi për shfrytëzimin e burimeve natyrore për industri i përfunduar	E parealizuar	- Strategjia është aprovuar më 29.06. 2023 dhe nuk ka pasur buxhet për zbatimin e këtij aktiviteti. Ky aktivitet është planifikuar të realizohet në vitin 2024. - Gjatë vitit 2024 janë përgatitur termat e referencës si dhe është shpallur tenderi, ku gjatë vlerësimit të tenderit OE nuk i kanë plotësuar kriteret dhe aktiviteti ka mbetur të realizohet gjatë vitit 2025.

Objektivi specifik 5.2: Përmirësimi i inovacionit të produktit drejt prodhimit me vlerë më të lartë të shtuar							
5.2.1	Ndarja e çmimit për inovacion në produkte prodhuese	TM4 2023 TM4 2024 TM4 2025	MINT-D. Inovacionit	MINT (Departamenti i Inovacionit dhe KIESA)	5 çmime në vit për produkte inovative	E parealizuar	- Këto çmime ndahen në ditën e Inovacionit në muajin prill ndërsa SZHIMB është aprovuar më datë 29.06.2023. Aktiviteti do të realizohet në TM2/2024 në ditën e inovacionit. - Aktiviteti nuk është realizuar gjatë vitit 2024 për shkak të buxhetit, dhe planifikohet të realizohet gjatë vitit 2025 në kuadër të aktivitetit ditët e inovacionit.
5.2.2	Reduktimi i tatimit në të ardhurat e korporatave për kompanitë e mëdha prodhuese që investojnë në entitete të përzgjedhura inovative	TM4 2023	MINT-D. Inovacionit- MFPT	MINT (Departamenti i Inovacionit) dhe MFPT	Të paktën 50 investime në entitete inovative	E parealizuar	Sipas MFPT, ky aktivitet duhet të largohet. Ligji për TAK është në mandat të MFPT-së dhe nuk pritet të ofrohet një gjë e tillë.
5.2.3	Finalizimi i Programit për Pronësinë Industriale	TM2 2023	MINT-API	MINT (Agjencia për Pronësi Industriale)	Programi për pronësi industriale i përfunduar dhe miratuar	E realizuar	Gjatë vitit 2023 nuk është miratuar, por ka qenë në proces, ndërsa është miratuar në vitin 2024
5.2.4	Mbështetja për institucione të arsimit të lartë për krijim të programeve ekzekutive të inovacionit në industri	TM4 2024	MASHTI dhe Institucionet e Arsimit të lartë	Buxheti i Kosovës dhe USAID Compete (TBD)	5 programe ekzekutive të inovacionit në industri të krijuara	E parealizuar	Nuk është Raportuar
Objektivi specifik 5.3: Forcimi i lidhjeve me ofruesit e shërbimeve vendase të lidhura me industrinë							
5.3.1	Zhvillimi i platformës digjitale me profile të detajuara të ofruesve të shërbimeve që lidhen me industrinë	TM4 2024	MINT (Departamenti i Tregtisë) dhe ASHI	MINT	Platforma digjitale e finalizuar	E realizuar pjesërisht / në proces	Kjo platformë është planifikuar të realizohet në kuadër të KIESA-s dhe të jetë pjese e softuerit të MINT për departamentet politikë bërës dhe KIESA. TeRs janë zhvilluar me përkrahje të LUXDEV KSV/023 dhe do të realizohet gjatë 2025, me fond të përbashkëta të LUX DEV dhe KIESA-s.
5.3.2	Mbështetja e masës preventive për mirëmbajtjen e	TM4 2024	MINT (KIESA)	MINT	100 ndërmarrje të mbështetura	E parealizuar	Ndonëse është masë e politikës industriale aktualisht nuk kemi miratim të buxhetit.



	makinerive në ndërmarrje prodhuese						
5.3.4	Themelimi i Këshillit Kombëtar për Zhvillim të Industrisë	TM4 2023	MINT-DI	MINT	Këshilli Nacional për Zhvillim të Industrisë i themeluar	E realizuar	Këshilli është themeluar me vendim të Kryeministrit